ISSN 1857-6443

Bujar Osmani
Të gjindet zgjidhje për PSP-në

Fq.3

EKSPORTI
Forca e industrisë ushqimore po zbehet

Fq.9

Ngjitja historisë!
Nazim Rashidi

Fq.10

www.koha.mk

Koha



Prostitucioni i detyruar

Fq.16

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XIII · Numri 3625 · e enjte, 4 prill 2019 · 7°c | 19°c · 15 DEN

KULTURË

Komikja dhe 'bordelizimi' i erotikës rurale

"Pranverë e paharruar, në fshatin e harruar" është filmi më i ri, por edhe i parë i metrazhit të gjatë, i regjisorit tash më të afirmuar dhe mirëpritur në mbarën hapësirën kulturore shqiptare, Kushtrim Bekteshi, i cili është edhe autor i skenarit. Vendosja e unitetit artistik midis skenarit dhe regjisë së të njëjtit autor, bëri që premiera e këtij filmi të...

Fq.18

RAJON

Borxhi publik rrezikon ta çojë Kosovën drejt krizës

Fq.14

GLOBI

Çfarë partie është CHP në Turqi?

Fq.15

EDITORIAL

Momenti i reformave

Fq.2

RRITJE E BUTË E NUMRIT TË FIRMAVE

BIZNESE ME 1 PUNËTOR

Të dhënat për strukturën e subjekteve afariste tregojnë se sipas numrit të të punësuarve në ekonominë tonë dominojnë me 79 për qind firmat me 1 deri 9 të punësuar, pasojnë firmat me 11.4 për qind firmat pa të punësuar, ndërsa firmat me 10 deri 19 të punësuar marrin pjesë me 4.3 për qind

Fq.7

Hendek në mes të gjykatave dhe shoqërisë

Shkup, 3 prill - Në prag të publikimit të raportit nga Komisioni Evropian (KE) për përparimin e reformave në gjyqësor, procesi shkon në drejtim të duhur. Ka ngelur edhe procesi kryesor i miratimit të ligjit për Prokurorinë Themelore Publike (PTHP), i cili praktikisht nënkupton zgjerimin e kompetencave të Prokurorisë Speciale Publike (PSP). Këto ishin komentet e ministres së Drejtësisë, Renata Deskoska, në konferencën për reforma në gjyqësor "Angazhim i përbashkët për arritje më të mira në gjyqësi" organizuar nga Institutit për të Drejta të Njeriut dhe Qendra për Studime Juridike dhe Analiza, në bashkëpunim me Shoqatën e Gjykatësve dhe Shoqatën për Administratë Gjyqësore.

"Në prag të Raportit të Komisionit Evropian për përparimin e vendit, është me rëndësi të theksohet se reformat shkojnë...

Fq.5

EDITORIAL

MOMENTI I REFORMAVE

Nga Fisnik PASHOLLI

Zgjidhja mbetet arritja e një kthese në zhvillimit e shoqërisë dhe të shtetit apo të një momenti të tillë psikologjik ku njerëzit më nuk do të thonë nuk bëhet gjë këtu, por do të kenë opsion të zgjedhin të jetojnë në vendlindjen e tyre me anët pozitive dhe negative të jetesës këtu, dhe të mund të zgjedhin edhe jetesën jashtë me të gjithë anët negativ dhe pozitive që mbart jetesa në perëndim.

Mbi 200 kompani me kapital gjerman punojnë në Maqedoninë e veriut që punësojnë mbi 20 mijë punëtorë dhe marrin pjesë në këmbimin tregtar të vlefshëm afër 3.6 miliardë euro .Ato kanë rritur eksportin prej 590 milion euro në vitin 2010 në 2 miliardë e 700 milionë euro në vitin 2018. Ato me 50 për qind e vlerësojnë të keqe situatën ekonomike në vend , dhe me 43 për qind të kënaqshme. Njëherazi perspektivat e ekonomisë vendore i vlerësojnë me 45 për qind të mira dhe me 43 për qind të pandryshuara. Andaj edhe anketa e fundit për vitin 2018 për problemet, telashet dhe ankesat e tyre lidhur me kushtet për udhëheqjen e biznesit duhet dëgjuar me kujdes të veçantë.

Mungesa e punëtorëve të kualifikuar ndikon në punën e tyre në mënyra të ndryshme. Një faktor i tillë me nga gati 50 për qind në mesatare e pengon procesin e prodhimtarisë, zvogëlon planet për investime dhe ndikon në refuzimin e porosive shtesë. Njëherazi këto biznese në anketën e fundit për ambientit e udhëheqjes së biznesit në vend, e vlerësojnë situatën ekonomike me 56 për qind si të keqe dhe me 39 për qind si të kënaqshme, ndërsa me vetëm 22 për qind i vlerësojnë perspektivat e ekonomisë si më të mira, me 24 për qind si më të këqija, dhe me 54 për qind si të pandryshuara.

Kompanitë gjermane në vend lidhur me kënaqësinë e kushteve të biznesit në mënyrë të kënaqshme janë shprehur për harxhimet e punës dhe produktivitetin dhe përgatitjen e punëtorëve. Të pakënaqur janë me luftën kundër korrupsionit, administratën publike , sigurinë juridike dhe ngarkesën tatimore. Është optimist dhe shpresëdhënës fakti se kompanitë gjermane në vend , përkundër problemeve të caktuara që i kanë theksuar në anketë , megjithatë në pjesën dërmuese do të investojnë sërish në Maqedoninë e veriut.

Nga ana tjetër , Banka Botërore vlerëson se për Maqedoninë e veriut, sfidat kryesore për rritjen ekonomike do të jetë produktiviteti i ulët dhe në rënie i kompanive lokale , institucionet e dobëta shtetërore, kapitali i ulët njerëzor, mospërputhja midis shkathtësive dhe kërkesave të tregut të punës të një ekonomie bashkëkohore si dhe pengesat politike ndaj konkurrencës dhe investimeve . Njëherazi korniza ligjore , ende nuk është për përkthyer në një sektor privat të gjallë që nxit rritjen ekonomike dhe hap vende të reja pune.

Janë për tu përshëndetur në këtë drejtim angazhimet qeveritare , për një llogaridhënie më të madhe për harxhimin e parave publike, miratimi i ligjit të ri për furnizime publike ....por megjithatë një sfidë e vërtetë mbetet puna e kompanive në pronësi të shtetit apo komunave që duhet të rrisin efikasitetitn e punës së tyre, të ulin humbjet në punën e tyre , të përmirësojnë cilësinë e punës së tyre ....

Nevojitet edhe krijimi i një situate ku bizneseve që veprojnë dhe punojnë në ekonominë e zezë apo informale, më shumë do t'ju shpaguhet të punojnë në binarët e ekonomisë formale dhe të rregullt. Gjithashtu nëse pagat në sektorin privat përcaktohen në treg në bazë të produktivitetit, atëherë nevojitet që edhe pagat në sektorin publik të bazohen në produktivitetin e punëtorëve. Apo të përcaktohet lartësia e pagës në sektorin publik në bazë të kompetencës, përgjegjësisë, ndërlikueshmërisë së punës, kushteve të punës dhe të ngjashme .

Njëherazi reformat strukturore për të cilat me vite me radhë flitet në Ballkanin perëndimor, nuk nënkuptojnë asgjë tjetër përveç ndryshimit të marrëdhënies së institucioneve politike dhe biznesit, të mënjanojnë shtetin nga rruga e afaristëve me qëllim që biznesi të punësojë , të paguajë tatime, dhe të realizojë profit. Të ulen vonesat në pagesa , të vendoset ekonomia informale në përmase optimale, të anulohen pritjet e shumta për një leje , apo të ndryshohet në aspekt real dhe jo vetëm formal kushtet e të bërit biznes në shtet.

Në këtë drejtim do të ishte i mirëseardhur, një debat njëmujor midis afaristëve apo biznesit, shkencës, dhe politikës që do të përcaktojnë të gjitha masat imediate dhe të nevojshme që së paku një pjesë e të rinjve të mos mendojnë të ikin , por të qëndrojnë në vendlindje, që të mos na ikin jashtë edhe ata që këtu fitojnë paga më se solide , por nuk janë të kënaqur me funksionimin e shoqërisë.

Na nevojiten masa afatshkurta dhe strategji afatgjate që do të adresojnë rrugën e vërtetë të zhvillimit ekonomik, apo të zgjidhin shkaqet dhe jo pasojat e problemeve të ndryshme .Vendi ndodhet në një apati në të cilën është mbërthyer një pjesë e konsiderueshme e popullatës. Zgjidhja e çështjes së emrit, anëtarësimi në NATO , dhe pritja që të fillohet me negociatat për anëtarësimi në BE nuk nënkupton se të jashtmit do të na e rregullojnë shtëpinë tonë , por ne vetë duhet të kryejmë detyrat e shtëpisë për të mirën e të gjithëve, si dhe për të hapur një perspektivë të qartë të jetesës edhe për të rinjtë që nesër do të jenë shtylla e zhvillimit të Maqedonisë së veriut. Ndaj , zgjidhja mbetet arritja e një kthese në zhvillimin e shoqërisë dhe të shtetit apo të një momenti të tillë psikologjik ku njerëzit më nuk do të thonë se nuk bëhet gjë këtu, por do të kenë opsion të zgjedhin të jetojnë në vendlindjen e tyre me anët pozitive dhe negative të jetesës këtu, dhe të mund të zgjedhin edhe midis jetesës jashtë me të gjithë anët negativ dhe pozitive që mbart jetesa në perëndim.

VRISNI SHPIRTIN E ROBIT



"Me siguri, secili që di të mendoje me kokën e vete, shpesh here e ka pyetur veten, si eshte e mundur qe ne, shqiptaret- e thotë historia, botes i kemi dhënë perandorë, vezirë, pashallarë, kryeministra e kryetare te shteteve te pushtuesve dhe te sunduesve, dhe, asnjehere nuk e kemi pasur asnjë (pervec Gjergj Kastriotit dhe Ismail Qemalit) qe do te bente nje shtet per të gjithë shqiptarët.
Përgjigja flen tek tek ata udhëheqës të shitur qe e kanë shpirtin e robit, i cili iu thotë: më i sigurtë i pari si shërbyes i të huajve se sa si shërbyes i popullit tim. Këtë më së miri e vërtetojnë kuislinget shqiptare te pushtetit aktual, të cilët, duke na "bindur" se shqiptarët e ngratë do ta kishin më mirë sikur ti mbronte një i huaj se sa një shqiptar. Hajde Sindromi i Stokholmit (kur i shtypuri solidarizohet me shtypësin) hajde", ka shkruar një status në Facebook", Shpëtim Pollozhani.

NJERËZ TË RINJ ME IDE TË REJA DHE MENTALITET TË RI



"Zgjedhjet e reja as në Prishtinë dhe as në Tiranë nuk do të zgjidhin problemet e vjetra. Shqiptarët në atdhe duhet të vendosin në krye dhe pushtet njerëz të rinj me ide të reja dhe mentalitet të ri. Zhvillimet globale dhe rajonale prej pasmajit 2019 e deri më 2025 do të jenë ndryshime thelbësore dhe shkundulluese dhe ne, nëse nuk sillemi përgjegjshëm dhe nuk ripozicionohemi si duhet, mund të përfundojmë shumë keq. Unë megjithatë besoj në popullin shqiptar dhe jam optimist që do t'ja dalim, por ky rezultat nuk do të ndodhë pa angazhimin serioz të secilit shqiptar dhe shqiptare", ka shkruar një status në Facebook, veprimtari Uk Lushi.

RRENCIT NUK I BAHET KURRË BOLL T'U RREJTË!



"Kaloi e hëna dhe një prilli. Rapsodi i njohur nga Drenica, Rexhë Kopiliqi, thurte vargje për ditët e javës the kur vinte tek e premtja thoshte: "E xhuma, kush ka rrejtë mos me rrejtë ma!" Por jo, ai që ka rrejtë deri tash ka me rrejtë gjithmonë, sepse rrena dhe hajnia janë vese impulsive, që do me thënë se edhe po deshe e ke vështirë t'i kontrollosh. Në anën tjetër, ato janë provuar si mjaft profitabile në hapësirat shqiptare. Krejt rrencat i kanë sot së paku nga dy tre milionë euro! Cilido politikan që ju thotë se 'boll ju kemi rrejtë', ai po ju premton se do të pushojë të ju rrejë më tutje, që do me thënë se po ju rren prapë, sepse rrencit nuk i bahet kurrë boll t'u rrejtë!", ka shkruar një status në Facebook, Liri Loshi

"Duhet të shterojnë të gjitha mundësitë për arritjen e marrëveshjes. fakti se ka bisedime, se ka propozime, se ka propozime nga njëra dhe nga ana tjetër, ka pasur edhe rreth të katërt në të cilin sërish është hapur debat lidhur me çështjet konkrete. Kjo është mirë dhe duhet të mbahet kjo dinamikë në tentimin për gjetjen e zgjidhjes dhe paralelisht ne të bisedojmë me ata që e sjellin vendimin në fund", tha Osmani

OSMANI ME THIRRJE DREJTUAR OPOZITËS

TË GJINDET ZGJIDHJE PËR PSP-në

Shkup, 3 prill - Zëvendëskryeministri për çështje evropiane, Bujar Osmani, dje deklaroi se duhet të gjindet zgjidhje për Prokurorinë Speciale Publike sepse kjo është një prej shtyllave në luftën kundër korrupsionit, krahas Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), Prokurorisë, Entit shtetëror për revizion (ESHR) dhe Trupi koordinues për luftë kundër krimit të organizuar dhe serioz.

Duke u përgjigjur në pyetje të gazetarëve pas vizitës së punës në Entin shtetëror se formalisht mandati i PSP-së përfundon në muajin shtator, ndërsa ata dëshirojnë që ligji për prokurorinë publike të sillet në qershor, para publikimit të Raportit të KE-së që të mund t'u lehtësohet vendeve anëtare të BE-së vendimi për hapjen e negociatave. "Nga dita e parë thash se duhet të punojmë në dy traektore, se zgjidhja më e mirë ideale do të ishte që të gjejmë konsensus të përgjithshëm sepse kjo do të reflektojë në kredibilitetin e institucionit, megjithatë edhe në mesazhin që e japim deri tek vendet anëtare se ne nuk dallohemi si parti politike nga cila do pjesë e spektrit lidhur me kthimin e qeverisjes së të drejtës. Duhet të shterojnë të gjitha mundësitë për arritjen e marrëveshjes. fakti se ka bisedime, se ka propozime, se ka propozime nga njëra dhe nga ana tjetër, ka pasur edhe rreth të katërt në të cilin sërish është hapur debat lidhur me çështjet konkrete. Kjo është mirë dhe duhet të mbahet kjo dinamikë në tentimin për gjetjen e zgjidhjes dhe paralelisht ne të bisedojmë me ata që e sjellin vendimin në fund", tha Osmani. Ai përkujtoi se ka dy parime të cilat janë të rënda për kompromis - autonomi të caktuar në funksionimin e një trupi antikorrupsion dhe përfundim të të gjitha indikacioneve nga materialet e përgjimit. Sipas tij, lënia e punës në gjysmë nuk i bën shërbim askujt dhe ky proces duhet të përfundojë. Rreth këtyre dy parimeve të cilat, siç tha, janë më fikse, ka hapësirë të gjindet zgjidhje.

Po dje, zëvendëskryeministri Osmani ka realizuar takim edhe me drejtoreshën rajonale të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) për Evropë dhe Bashkësitë e shteteve të pavarura, Mirjana Shpoljariq- Eger. Në takim u hapën temat për planet aktuale dhe të ardhshme të UNDP-së në vend, si dhe u diskutuan edhe sfidat zhvillimore në aspektin e procesit të integrimit evropian, fushë në të cilën UNDP ka përparësi konkurruese, përvojë dhe mandat për mbështetje të Maqedonisë së Veriut si partner afatgjatë.

"Aktualisht ndodhemi në periudhë parazgjedhore, në prag të fushatës parazgjedhore, që, edhe pse i kënaq proceset, nuk duhet të paraqesë pengese që të vazhdojmë me zbatimin e reformave për integrimin evropian të vendit, dhe në këtë kuptim, partneriteti strategjik me UNDP për mbështetjen e agjendës për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në BE është e mirëseardhur", theksoi Osmani, ndërsa potencoi Raportin pranveror për gjendjen dhe progresin e vendit nga ana e Komisionit Evropian, do të reflektojë momentumin pozitiv reformues në vend. Ai përshëndeti edhe mbështetjen e UNDP-s për Qeverinë për shfrytëzimin e procesit të integrimit në BE për të arritur një rritje të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të përshpejtuar në përputhje me praktikat më të mira, përvojat ndërkombëtare dhe rajonale, që sipas tij do të jetë përmirësim i jetës së qytetarëve në përputhje me standardet evropiane. (Z.V)

Publicitet

Një shoqëri për të gjithë, koncepti i vetëm produktiv

Shkup, 3 prill - Maqedonia si një shoqëri për të gjithë, është gjëja për të cilën zotohem unë dhe ato që më mbështesin. Ky koncept është i vetmi produktiv për shtetin në rrethinën e tillë jo të qetë ballkanik dhe shteti me dallimet të tilla etnike dhe religjioze siç është Maqedonia, tha kandidati presidencial i LSDM-së dhe koalicionit, Stevo Pendarovski në takimin me qytetarët e Komunës së Aerodromit. Maqedonia duhet të ecë përpara, ndërsa kjo është mundur nëse të gjithë ecim para dhe nëse zgjidhen problemet, që sipas tij, e bënë kjo Qeveri. Progresin e vendit, siç tha, Pendarovski e mundëson edhe Marrëveshja e Prespës. "Për fat të mirë u paraqit një gjeneratë e re e politikanëve të Maqedonisë të cilët vendosën të mos i vendosin problemet nën qilim dhe që është shumë e rëndësishme, me çmim të popullaritet personal në rejtingun e vet politik dhe mundësinë të humbë në zgjedhjet e ardhshme, t'i zgjidh problemet më të mëdha të cilat ky shtet i ka dhe këtë e kemi bërë", tha Pendarovski dhe shtoi se politika e tillë ka dhënë fryte , që sipas tij shihet edhe nga vizita e kryeministrit të Greqisë.

REKA NË FSHATRAT E STUDENIÇANIT

BESËLIDHJE SHQIPTARE KARSHI UJDISË SË PUSHTETIT

Gjatë bashkëbisedimit me qytetarët, Reka theks të veçantë i kushtoi rëndësisë së daljes masive në votime, pavarësisht se cilës parti i takojnë qytetarët. Ai saktësoi se me votën tuaj, tregoni se nuk jemi 20 për qind anonim

Shkup, 3 prill - I shoqëruar nga kreu lideri i Lëvizjes BESA, Bilall Kasamii si dhe lideri i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela, kandidati për president, prof. Blerim Reka, pasditen e djeshme ka vizituar fshatrat Çeflik, Patishka Reka, Batincë dhe Studeniçan. Lideri i Lëvizjes BESA, Bilall Kasami, gjatë tubimeve hapur potencoi se përkrahja e kandidaturës së prof. Rekes është sepse besojnë fuqishëm në konceptin e një shteti apo Republike për të gjithë.

"Kjo është rruga e vetme që do bëjë Maqedoninë e Veriut shtet me vlera evropiane. Maqedonasit duke votuar për prof. Blerim Rekën tani e kanë shansin të dëshmojnë se a janë të jemi shtet që do jetë i barabartë si për maqedonasit ashtu edhe për shqiptarët. Ne u themi qartë se pa shqiptarë të barabartë në udhëheqjen e shtetit e ardhmja e Maqedonisë të Veriut do jetë e pasigurt", u shpreh Kasami. Kreu i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela, ndërkohë vlerësoi se kandidatura e prof. Blerim Rekës ka nderuar gjithë shqiptarët, pasi që me këtë, çdo shqiptari i ofrohet mundësia e përfaqësimit. "Nuk e kam fjalë për ata shqiptarë që nuk e ndjejnë veten shqiptarë, por për shqiptarët që janë lindur dhe rritur me nënë dhe babë shqiptar, që frymojnë shqip. Nëse doni të testoni ato parti shqiptare që janë në Qeveri se sa janë të sinqertë në atë që e bëjnë, i ftoni të vinë këtu para juve krah për krah me Stevon edhe le ti kërkojnë votat tuaja, por ata nuk mund të dalin para juve. Ata këtë e bëjnë vetëm për pushtet dhe futen në kategorinë e njëjtë me Amdi Bajramin", tha Sela.

Gjatë bashkëbisedimit me qytetarët, Reka theks të veçantë i kushtoi rëndësisë së daljes masive në votime, pavarësisht se cilës parti i takojnë qytetarët. Ai saktësoi se me votën tuaj, tregoni se nuk jemi 20 për qind anonim. "Të tjerët ofrojnë konsensualitet, që në shqip do të thotë ujdi, por për fat të keq, ata i japin përparësi ujdisë me fqinjin, ndërsa në rastin tonë bëhet fjalë për ujdi mes vëllezërve të një gjaku. Dy liderët e partive opozitare kanë bërë një besëlidhje që të përkrahin një kandidat shqiptar për president, dhe me këtë ata dëshmuan se janë për faktorizimin e votës shqiptare", theksoi Reka.

Ai ka folur edhe për perspektivën e të rinjve në Maqedoninë e Veriut. "Vendi u zbraz për një çerek, kurse paralajmërimet janë që deri në 2030, mund të ikë edhe çereku tjetër i popullsisë. Këtë ikje nuk e shkakton vetëm papunësia, por edhe lodhja e qytetarit nga nepotizmi dhe korrupsioni, nga mungesa e sundimit të ligjit dhe nga gjyqësori i politizuar. Nuk ka perspektivë edhe kur vendi me vite renditet ndër më të ndoturit në botë. Nëse tani nuk e rikthejmë Republikën në binaret euroatlantike, ç'na duhet nesër anëtarësimi në BE, si shtet i zbrazur kur veçmë gjysma e popullatës do të jetë e 'integruar' në BE. Si president i ardhshëm i Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të punoj në parandalimin e integrimit në BE si shtet i zbrazur".

Siljanovska: Maqedonia do të jetë gjithçka kemi

Resnjë, 3 prill - Maqedonia përsëri do të jetë gjithçka kemi, pasi ne nuk kemi zgjidhje tjetër, porositi profesoresha Gordana Siljanovska Davkova, kandidate për presidente e VMRO-DPMNE-së në tubimin e mbrëmshëm në Resnjë. Duke e kërkuar besimin e tyre të banorëve të Prespës ajo u ndal në ndryshimin e emrit kushtetues të shtetit duke theksuar se emri lidhet për kombin, për njerëzit, për maqedonasit. "Ne nuk kemi një Maqedoni tjetër. Nuk ekziston Republika e Maqedonisë së Jugut. Është qesharake dikush të mendojë se nga territori e kemi marrë emrin. Nëse kemi ekzistuar edhe në Perandorinë Otomane edhe në të gjitha betejat. Nëse më 8 shtator votuam për Maqedoninë në numër të madh, si atëherë pa dhimbje ta lexojmë preambulën në të cilën shkruan se ilindenasit dhe partizanët kanë luftuar për Maqedoninë e Veriut. Nuk është e Veriut është e tyre, ndërsa Maqedonia është e jona", tha Siljanovska. Për hyrjen e vendit në NATO, theksoi se është i nevojshëm plotësimi i kritereve si edhe në Bashkimin Evropian, por nënvizoi se Maqedonia nuk ka ambasador në Aleancë, i cili duhet të organizojë gjithçka në vigjilje të hyrjes.

FUSHATË E BDI-SË NË VENDBANIMET E SHKUPIT

Në tavolinë, dimë të drejtojmë tavolinën

"Hoqëm dorë nga patriotizmat pa mbulesë duke qenë pragmatik dhe racional se si duam arrijmë deri tek qëllimi. E hodhëm idenë e presidentit konsensual dhe si ide e kemi paraqitur te të dy palët. Duhet të jemi realist, ne nuk mund të realizojmë përmes votës dhe garës me palën maqedonase zgjedhjen e një presidenti të shtetit...", tha Ahmeti

Shkup, 3 prill - Në kuadër të fushatës për zgjedhjet presidenciale 2019, Bashkimi Demokratik për Integrim të martën mbrëma ka zhvilluar një tubim më qytetarët e Komunës së Shuto Orizares, Butelit dhe Çuçer Sandëvës. Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, në fjalimin e tij para të pranishmëve bëri të ditur se janë pjekur kushtet për ta votuar një kandidat të përbashkët për president që do të përfaqëson të gjitha etnitë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. "Hoqëm dorë nga patriotizmat pa mbulesë duke qenë pragmatik dhe racional se si duam arrijmë deri tek qëllimi. E hodhëm idenë e presidentit konsensual dhe si ide e kemi paraqitur te të dy palët. Duhet të jemi realist, ne nuk mund të realizojmë përmes votës dhe garës me palën maqedonase zgjedhjen e një presidenti të shtetit. Por ama siç i realizojmë që numëruan bashkëpunëtorët e mi, siç janë ministrin e Mbrojtjes, Ministrin e Brendshme, Avokatin e Popullit, Kryetarin e Parlamentit..., ashtu do të realizohen këto qëllime. Këtu ka një dallim mes nesh dhe partive tjera të vogla. Dallimi është sepse unë - Ali Ahmeti, nuk llogaris se a do t'i fitoj zgjedhjet e ardhshme apo jo. Por unë punoj së bashku me bashkëpunëtorët e mi për të bërë vepra të mira, të cilët do të jenë të dobishme për shqiptarët dhe tani vendosin qytetarët se kujt do ti japin mandatin", tha Ahmeti.

Dhe kjo, vazhdoi më tej ai, neve na ka mbajtur të pamposhtur dhe të paluhatshëm 18 vite radhazi edhe pse të gjitha shënjestrat i kanë pasur kundër BDI-së për ta rrëzuar, sepse paraqitet pengesë se ne promovojnë program, vizion dhe ide dhe kjo ju pengon të tjerëve. "Në tavolinë ne dimë të drejtojmë tavolinën dhe në negociatat dimë të drejtojmë negociatat dhe me krenari i kemi mbrojtur kërkesat dhe avancimin e shqiptarëve në këto hapësira. Tapia jonë është këtu në këtë vend dhe tapisë duhet ti dalim zot. Tani kemi arritur të merremi vesh për kandidat konsensual, të përbashkët apo i Qeverisë, si të doni quani, por ne nuk fshihemi pasi që ka edhe prej atyre që fshihen si të pavarur dhe kryejnë detyrat e tjetërkujt", tha mes tjerash lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, ndërsa shtoi se me zgjidhjen e kontestit të emrit me Greqinë fqinje, Maqedonia do të fillojë bisedimet për anëtarësim me BE-në dhe do të bëhet anëtare e plotfuqishme e NATO-s që është garanci për një jetë më të mirë për qytetarët.

Raport pozitiv, bisedimet pak më vonë

Bruksel, 3 prill - Komisari për zgjerim i Komisionit Evropian, Johanes Han, para deputetëve evropian në Komisionin për punë të jashtme, ka thënë se KE me siguri do të rekomandojë negociata për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë më 29 maj, por i ka siguruar skeptikët se ky proces është gradual dhe se bisedimet nuk do fillonin menjëherë. Komisionari ka kujtuar situatën e aktorëve jashtë rajonit që ndërhyjnë nëse politika e BE-së nuk merr masa konkrete.

"Në maj do t'i prezantojmë raportet për progresin e vendeve dhe presim në bazë të asaj që do ta konstatojmë dhe do të japim rekomandime për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, se ato duhet të hyjnë në fazën përgatitore të negociatave, veçmas pas zhvillimit pozitiv në Maqedoninë e Veriut", ka thënë Han para eurodeputetëve. Ai ka rikujtuar se vitin e kaluar shumica e vendeve anëtare kanë pasur qëndrim pozitiv për negociatat me faktin se Marrëveshja e Prespës tani është miratuar dhe implementohet dhe se "duhet të kalohet në fazën tjetër". Burime diplomatike nga Brukseli për MIA shpjegojnë se skenari ideal do të ishte në qershor në Këshillin e Punëve të Përgjithshme, shtetet anëtare të japin sinjal politik, ose të miratojnë hapjen e negociatave qasë-se me çka fillon fazë përgatitore për të cilën flet komisari. Me rëndësi është të theksohet se Maqedonia duhet të miratojë edhe kornizën e saj negociuese poashtu. Ky është skenari ideal në të cilin synon KE, por çështja është nëse vendet si Franca, tani edhe Gjermania do të pranojnë sinjal politik në qershor.

Han në paraqitjen e djeshme ka tentuar madje të qetësojë skeptikët se bëhet fjalë për fazë përgatitore dhe se të gjithë e mbajnë të drejtën e tyre të vetos në gjithë procesin.

Ndërkohë, parlamentarë evropianë kërkuan shpjegime për situatën e vetos nga vendet anëtare pas vendimeve të Komisionit Evropian, duke e parë këtë si një pengesat kryesore për pranimin e vendeve të reja. Komisioni i jashtëm parlamentar mori të hënën në shqyrtim raportet për vendet të hartuara nga europarlamentarët, ndërkohë që ka vlerësuar se situata financiare e parashikuar në fondet IPA 2021-2027 mbështet zgjerimin dhe zhvillimin ekonomik në rajon. Han ka përsëritur faktin se nëse Evropa nuk eksporton stabilitet në Ballkan, do të importojë destabilitet.

REFORMAT NË SISTEMIN E DREJTËSISË

HENDEK NË MES GJYKATAVE DHE SHOQËRISË

Sektori Civil nuk i miraton ligjet, ato i propozon dhe miraton politika. Në të shumtën e rasteve ndodhë të ketë mospajtime midis palëve

Koha — Destan JONUZI

Shkup, 3 prill - Në prag të publikimit të raportit nga Komisioni Evropian (KE) për përparimin e reformave në gjyqësor, procesi shkon në drejtim të duhur. Ka ngelur edhe procesi kryesor i miratimit të ligjit për Prokurorinë Themelore Publike (PTHP), i cili praktikisht nënkupton zgjerimin e kompetencave të Prokurorisë Speciale Publike (PSP). Këto ishin komentet e ministres së Drejtësisë, Renata Deskoska, në konferencën për reforma në gjyqësor "Angazhim i përbashkët për arritje më të mira në gjyqësi" organizuar nga Institutit për të Drejta të Njeriut dhe Qendra për Studime Juridike dhe Analiza, në bashkëpunim me Shoqatën e Gjykatësve dhe Shoqatën për Administratë Gjyqësore.

"Në prag të Raportit të Komisionit Evropian për përparimin e vendit, është me rëndësi të theksohet se reformat shkojnë në drejtim të duhur. Jam e bindur se në frymën e reformave do të miratohet edhe ligji për Prokurorinë Publike. Edhe pse një pjesë bukur e mirë e rregullativës ligjore ka përfunduar, sfidat edhe më tej janë të pranishme. Ka ngelur edhe procesi kryesor i reformave, siç është miratimi i ligjit për Prokurorin Publike, i cili praktikisht do të thotë ruajtje të statusit dhe zgjerimin e kompetencave të Prokurorisë Speciale Publike dhe të mundësohet që ajo të ketë të drejtën që të luftoj me kriminalitetin dhe korrupsionin në vend", theksoi Deskoska. Ajo potencoi se perspektivat e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë fokusuar në ndërtimin e një sistemi efikas dhe të pavarur gjyqësor.

"Me angazhim dhe përkushtim të madh punojmë në përgatitjen e zgjidhjeve ligjore, por jo vetëm edhe në krijimin e politikave përmbajtësore. Prioritetet tona kryesore janë zgjidhjet ligjore që garantojnë gjyqësor efikas dhe të pavarur, por edhe ushtrim të detyrës në mënyrë profesionale nga ana e gjyqtarëve, si dhe përgjegjësi të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve publik. Në periudhën e kaluar, ishim të fokusuar në një agjendë voluminoze ligjore, e cila kishte të bënte me miratimin e një numri të madh të ligjeve reformuese", potencoi Deskoska.

Deskoska njoftoi se në procedurë të shkurtuar parlamentare dhe në fazën përfundimtare ligji për Këshillin Gjyqësor që paraqet tërësisht një ligj të ri. Ndërsa në procedurë parlamentare është lëshuar edhe ligji për ndryshime dhe plotësime për Këshillin e Prokurove Publik. Për efikasitet më të madh të Gjykatave administrative është hartuar ligj i posaçëm, ndërsa në procedurë parlamentare është edhe ligji për ndihmë falas gjyqësore, që u japim mundësi që një numër i madh i qytetarëve të kenë qasje deri të drejtësia dhe të fitojnë gjykim të drejt dhe korrekt.

"Janë bërë edhe disa reforma kyçe në luftën kundër korrupsionit, për çfarë është nxjerrë edhe Ligji i ri për parandalimin e korrupsionit dhe u zgjodh përbërja e re e Komisionit për anti-korrupsion. Ndaj të cilës janë orientuar sytë e opinionit dhe qytetarëve në luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave. Punojmë në përforcimin e institucioneve gjyqësore, por gjithashtu punojmë edhe në rritjen e kapaciteteve kadrovike në ministrin e drejtësisë. Në pajtueshmëri me ndryshimet në ligjin për gjykatat, është përgatitur edhe plan vjetor për mbikëqyrje të gjykatave, për aplikimin dhe zbatimin e normave të Rregullores së punës së Gjykatave. Me këtë plan vjetor 16 gjykata janë në planin e mbikëqyrjes", njoftoi Deskoska. Ajo, po ashtu theksoi se kanë marrë edhe vlerësime të mira nga institucionet ndërkombëtare për reformat që janë zhvilluar deri më tani dhe për Ligjin për Këshillin Gjyqësor Republikan. Nga ana tjetër, Lidija Stojkova Zafirovska nga Qendra për Hulumtime Juridike dhe Analiza, tha se gjykatat dhe sektori civil nuk miratojnë ligje andaj edhe ndikimin ndaj gjyqësorit nuk mund ta themi vetëm si pro-formë.

"Gjykatat, as Sektori Civil nuk i miraton ligjet, ato i propozon dhe miraton politika. Në të shumtën e rasteve ndodh që të ketë mospajtime midis palëve. Prandaj nuk mund të themi se ka ndikim ndaj gjyqësorit, dhe kjo të jetë vetëm sipërfaqësisht", deklaroi Stojkova Zafirovska. Ndërkaq, Margarita Caca Nikollova nga Instituti për Drejtat e Njeriut, theksoi se në çdo shoqëri demokratike, sektori civil është shumë i rëndësishëm në proceset e arritjes së drejtësisë dhe proceset e krijimit të politikave.

"Ajo që është e rëndësishme të theksohet është se sektori civil tani luan rol të rëndësishëm, se sa në të kaluarën. Qytetarët janë më të hapur që të bashkëpunojnë me sektorin civil dhe së bashku të ndërmarrin ndonjë aktivitet. Jam e bindur se me një angazhim të të gjithëve do të arrihet drejtësia, por jo vetëm edhe reforma më efikase në jurisprudencë. Të gjitha angazhimet tona janë fokusuar për të arritura më të mira në gjyqësor. Të arriturat më të mira në gjyqësor nënkuptojnë angazhim të të gjitha subjekteve të përfshira në procesin e reformave", theksoi Caca Nikollova.

Gazetarja Snezhana Lupevska Sozen, e cila për disa vite merret me gazetari hulumtuese, tha se për dallim nga e kaluara gjykatat kohëve të fundit kanë filluar të hapen më tepër për gazetarët dhe opinionin. "Nëse flasim si gazetar, apo në aspektin e opinionit, në të shumtën e rasteve për fat të keq nuk jemi në anën e njëjtë me gjyqësorin. Dimë të japim kritika për gjyqësorin, dhe ju në të shumtën e rasteve "zemëroheni" kur vlerësimet gjeneralizohen. Ajo që më parë e kemi pasur si vërejtje ka qenë jo-transparenca dhe si të ngritët niveli i komunikimit me opinionin, ne këtë drejt duhet të pranojë se situata dukshëm është përmirësuar, në raport me transparencën dhe kontaktet me opinionin gjegjësisht me gazetarët", potencoi Lupevska Sozen. Sikundër dihet, Konferenca "Angazhim i përbashkët për arritje më të mira në gjyqësi" është pjesë e projektit IPA II i financuar nga Bashkimi Evropian përmes Sektorit për financim qendror dhe dakordimin e marrëveshjeve në kuadër të Ministrisë së Financave.

Shkup, 9 të lënduar në 11 aksidente

Shkup, 3 prill - Nëntë persona më lehtë janë lënduar në shtatë prej gjithsej 11 fatkeqësive të cilat kanë ndodhur gjatë njëzet e katër orëve të kaluara në rajonin e Qytetit të Shkupit. Në katër fatkeqësi është shkaktuar dëm material. Sipas të dhënave të SPB Shkup, janë dhënë masa ndëshkuese për 18 shoferë të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se shpejtësia e lejuar, një shofer i cili e ka drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit, 12 para se ta fitojnë të drejtën e drejtimit të automjetit motorik dhe katër shoferë fillestarë.

Nga komunikacioni janë përjashtuar edhe 12 automjete të paregjistruara. Janë dhënë edhe gjoba për 71 automjete për parkim jo të drejtë, ndërsa me automjetin special "karrotreci" janë larguar 54 automjete.

Janë sanksionuar edhe katër shoferë të cilët kanë kaluar udhëkryqin në semafor të kuq, katër shoferë të cilët nuk u kanë dhënë përparësi kalimi këmbësorëve në një vendkalim të shënuar për këmbësorë, dy për rreshtim jo të drejtë, një për tejkalim jo të drejtë, dy drejtues të motorit, mopedit dhe motoçikletës për mospërdorimin e helmetës, një për mosmbajtjen e rripit të sigurisë dhe tre për përdorimin e telefonit celular.

Policë hungarezë në kufijtë e Maqedonisë së Veriut

Budapest, 3 prill - Autoritetet hungareze kumtuan se 15 policë do të sistemohen si ndihmë në kufirin midis Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut, ndërsa 30 në kufirin midis Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë. Siç thuhet në kumtesë, masa ndërmerret për shkak të parandalimit të kalimeve ilegale në Serbi dhe Maqedoninë e Veriut dhe arrestimin e kontrabanduesve me njerëz. Njësitet policore do të jenë të pajisur me automjete, të cilat do të mund të lëvizin jashtë autostradave, me pajisje për vëzhgim gjatë natës dhe me kamera termale. "Polica hungareze vazhdon të bashkëpunojë me forcat lokale për mbrojtjen e kufijve midis Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut si edhe Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë", kumtoi MPB hungareze.

PROPOZIM-LIGJ I RI

KOMISIONI PËR QASJE TË LIRË BËHET AGJENCI

Në procedurë është Ligj i ri për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacionet me karakter publik. Ky ligj parasheh që Komisioni i deritanishëm të shndërrohet në Agjenci, që do të ketë drejtor dhe zëvendësdrejtor, të cilët do ti zgjedh Parlamenti, ndaj të cilit duhet të japin edhe llogari për punën e tyre

Koha — Destan JONUZI

Shkup, 3 prill - Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik me propozimligjin e ri për qasje të lirë në informacione me karakter publik bëhet Agjenci. Kryetari i këtij Komisioni, Blerim Hyseni, thotë se me shndërrimin e Komisionit në Agjenci, do kenë të drejtën edhe të inspektimit dhe shqiptimit të dënimeve.

"Komisioni nga një trup prej pesë anëtarësh (kryetar, zv/kryetar dhe 3 anëtarë), shndërrohet në Agjenci me drejtor dhe zëvendësdrejtor. Si posedues të informacioneve me karakter publik trajtohen edhe partitë politike, që nënkupton se edhe nga ato mund të kërkohet informata me karakter publik. Do të ketë të drejtë inspektimi nëpërmjet inspektorëve të Agjencisë. Në rast se nuk zbatohen vendimet e Agjencisë, ka të drejtë të shqiptimit të dënimeve për poseduesit e informatave me karakter publik", deklaroi për gazetën KOHA, Blerim Hyseni, kryetar i Komisionit për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik.

Drejtorin dhe zëvendësdrejtori, sipas Ligjit, për punën e tyre japin llogari para Parlamentit, i cili po ashtu bën edhe emërimin, gjegjësisht zgjedhjen e tyre. Siç mëson KOHA, partitë e shumicës parlamentare madje janë marrë vesh që njëri nga këto dy poste t'i takojë një përfaqësuesi shqiptar. Propozimligji bazohet në parimet e ligjshmërisë, profesionalitetit, përgjegjësisë, llogaridhënies dhe transparencës. Ky ligj, po ashtu rregullon edhe mënyrën dhe procedurën për arritjen e të drejtës për qasje të lirë deri të informacionet me karakter publik me të cilat disponojnë organet shtetërore dhe organizata tjera të përfshira në ligj, komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat urbane, institucionet dhe shërbimet publike, ndërmarrjet publike, persona fizik dhe juridik që ushtrojnë autorizime publike të përcaktuara me ligj, si dhe veprimtari me interes publik, partitë politike në pjesën e të ardhurave etj.

Me këtë ligj, sipas Ministrisë së Drejtësisë si propozuese, sigurohet hapje dhe përgjegjësi në punën e bartësve të informacioneve me karakter publik dhe u mundësohet personave fizik dhe juridik që të kenë qasje të lirë në informacionet me karakter publik. Sipas ligjit, bartësit e funksioneve publike obligohen që të sigurojnë informacione për opinionin.



Blerim Hysani

Komisioni nga një trup prej pesë anëtarësh (kryetar, zv/kryetar dhe 3 anëtarë), shndërrohet në Agjenci me drejtor dhe zëvendësdrejtor. Si posedues të informacioneve me karakter publik trajtohen edhe partitë politike, që nënkupton se edhe nga ato mund të kërkohet informata me karakter publik. Do të ketë të drejtë inspektimi nëpërmjet inspektorëve të Agjencisë. Në rast se nuk zbatohen vendimet e Agjencisë, ka të drejtë të shqiptimit të dënimeve për poseduesit e informatave me karakter publik

AUTOPSI MBI TRUPAT E FAMILJES BULLGARE

"CESNA" u rrëzua nga turbulencat e forta?

Shkup, 3 prill - Aeroplani bullgar "CESNA", në rajonin e "Majës së Selanikut", është rrëzuar për shkak të turbulencave të forta. Kështu thonë informacionet e para nga terreni. Pas ngjarjes tragjike ku mbetën të vdekur katër persona, Georgi dhe Kalina Boshnakova, (afarist dhe avokate) dhe dy vajzat e tyre, prokurori i Prokurorisë së Shkupit ka dalë në vendngjarje dhe ka kryer ekspertizë. Njëherit ndaj trupave të pajetë është realizuar autopsi. Përpos prokurorisë përkatëse, në vendngjarje për realizimin e ekspertizë dhe vërtetimit të shkaqeve të aksidenti kanë dalë edhe ekipe të Ministrisë për Punë të Brendshme dhe institucioneve tjera relevante.

"Vendi ku është rrëzuar aeroplani gjendet në një terren skajshmërish të paarritshëm dhe për momentin nuk ekzistojnë kushte për tërheqjen e fluturakes. I gjithë lokacioni është shënuar, ndërsa ekspertë nga Reparti për hetime dhe ekspertizë tekniko-kriminogjene nga MPB dhe Komiteti për hetime të aksidenteve të fluturimit do të kryejnë ekspertizë mbi mbetjet e aeroplanit, me qëllim konstatimin e shkaqeve të kësaj fatkeqësie", thonë nga Prokuroria Publike.

Ngjarja tragjike, sipas të dhënave zyrtare, ka ndodhur ditën e martë (2 prill) rreth orës 16:15. Relacioni i aeroplani të aksidentuar, të cilën e ka drejtuar 49-vjeçari i ndjerë Boshankov, ka qenë nga Aeroporti i Ohrit drejtë atij të Sofjes. Ndërkohë, për shkak të kushteve të rënda të motit, ai ka kërkuar aterrimin në Aeroportin e Shkupit, me çka e ka ndërruar mendjen dhe ka vazhduar fluturimin drejtë Sofjes. Kështu që, pas ora 16:00 aeroplani humbet nga radarët mbi Shkup, gjegjësisht fjalët e fundit mes pilotit dhe aeroportit kanë qenë "Turbulenca e fortë...". Ndryshe, përveç kushteve të rënda klimatike, mbi

të cilat ka fluturuar aeroplani, ekspert të fushës së aviacionit kanë komentuar se aksidentet e tilla mund të shkaktohen edhe nga gabimi i pilotit apo ndonjë defekt në fluturake. *(O.XH)*

RRITJE E BUTË E NUMRIT TË FIRMAVE

BIZNESE ME 1 TË PUNËSUAR

Të dhënat për strukturën e subjekteve afariste tregojnë se sipas numrit të të punësuarve në ekonominë tonë dominojnë me 79 për qind firmat me 1 deri 9 të punësuar, pasojnë firmat me 11.4 për qind firmat pa të punësuar, ndërsa firmat me 10 deri 19 të punësuar marrin pjesë me 4.3 për qind

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 3 prill - Në Maqedoninë e Veriut, në vitin 2018 janë hapur 896 kompani të reja në raport me vitin 2017. Sipas të dhënave të Entit të Statistikës, vitin e kaluar kanë punuar 72.315 biznese që është për 1.3 për qind në raport me 71.419 biznese që kanë vepruar në shtet në vitin 2017. Një rritje e tillë i detyrohet kryesisht rritjes së numrit të subjekteve afariste aktive në sektorin e informacionit dhe komunikacionit, ku janë hapur 167 firma, veprimtarive të tjera shërbyese me 377 kompani dhe tek furnizimi me energji, klimatizim dhe të ngjashme me 14 firma. Në ndërkohë, të dhënat për strukturën e objekteve afariste tregojnë se në vitin 2018, me afër 32 për qind apo 22.950 kompani në totalin e bizneseve dominon tregtia me pakicë dhe shumicë, e pasuar nga industria e përpunimit me 11 për qind apo 8033 firma. Në vendin e tretë, sipas numrit të bizneseve me 7261 firma është veprimtaria shkencore, teknike dhe profesionale. Nga sektorët e tjerë të rëndësishëm të një ekonomie nacionale dallohen edhe transporti me 5667 firma, ndërtimtaria me 4938 firma, firmat e hotelerisë ku përfshihen edhe restorantet e llojeve të ndryshme me 4597 firma, etj.

Njëherësh të dhënat për strukturën e subjekteve afariste tregojnë se sipas numrit të të punësuarve në ekonominë tonë dominojnë me 79 për qind firmat me 1 deri 9 të punësuar, pasojnë firmat me

11.4 për qind firmat pa të punësuar, ndërsa firmat me 10 deri 19 të punësuar marrin pjesë me 4.3 për qind. Më pak në numër janë firmat që punësojnë më shumë punëtorë. Bizneset që punësojnë 20 deri 49 të punësuar janë 2.9 për qind, pasojnë firmat me 50 deri 249 të punësuar me 1.9 për qind dhe në fund me vetëm 0.3 për qind janë kompanitë e mëdha me më shumë se 250 të punësuar. Në ndërkohë, ekonomistët vlerësojnë se në Maqedoni nuk mungojnë shpirti sipërmarrës dhe projektet e ndryshme inovative, por mungon një mbështetje edhe më e madhe dhe gjithëpërfshirëse se ajo ekzistuese e orientuar ndaj prodhimit, ideve të reja, eksportit të shërbimeve të ndryshme. Vlerësohet se plani i ri qeveritar për përkrahje të inovacionit dhe sipërmarrjes paraqet një ndihmesë për zhvillimin e biznesit,megjithatë për efekte më të mëdha ekspertët sugjerojnë një fokus më të madh ndaj zhvillimit të kapitalit njerëzor.

"Sipërmarrësia tek ne shënon rritje të vazhdueshme, por megjithatë akoma nuk është e zhvilluar mjaftueshëm. Ajo kërkon më shumë mbështetje, ndihmë nga ana e mentorëve profesional etj si dhe promovim para opinionit dhe të rinjve, me qëllim që të rinjtë më shumë ti orientojmë ndaj punës dhe hapjes së bizneseve vetanake në vend të fokusohen të punojnë në institucionet shtetërore apo në fabrikat e mëdha", thonë konsulentët e biznesit.

Në ndërkohë, frika nga ndërmarrja e rrezikut dhe mungesa e financave vlerësohen se janë shkaqet kryesore që të rinjtë në Maqedoni më rëndë vendosin të hapin biznesin e tyre. Dobësitë dhe rreziqet kryesore të sipërmarrjes rinore janë hendeku i madh midis sektorit të biznesit dhe atij të arsimit, sistemi gjyqësor joefikas, qasja e dobët ndaj financave, apatia e përgjithshme te të rinjtë për gjendjen në shtet, ikja e të rinjve në tregun e punës jashtë shtetit, mosbesimi ndaj sistemit, korrupsioni dhe administrata akoma e ngadalshme.

Sipas hulumtimit, "Sfidat dhe nevojat e sipërmarrësve të rinj në Maqedoni", të përgatitur nga Rrjeti për përkrahje e sipërmarrësve të rinj, në shtet nuk mungojnë masa pozitive dhe reforma për përkrahjen e sipërmarrjes dhe zhvillimin e sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, por megjithatë ato janë të pamjaftueshme dhe nevojitet të ndërmerren edhe më shumë hapa të tjera në shtytjen më të madhe të rinjve që të merren me sipërmarrësi.

MINISTRI TURK I MBROJTJES VIZITON MAQEDONINË

Protokollin e NATO-s Turqia e kushtëzon me FETO-n

"I kemi emrat e disa prej më kryesorëve të organizatës terroriste, që janë ndarë mes institucioneve të dy vendeve dhe jam thellë i bindur se gjatë ditëve të ardhshme institucionet e Maqedonisë së Veriut do ta ndërmarrin masa konkrete rreth kësaj. U besoj institucioneve të Maqedonisë së Veriut", tha mes tjerash ministri Hulusi Akar

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 3 prill - Me Turqinë na lidh miqësia e fuqishme që zgjat gjatë dekadave të fundit, ndërsa lidhjet në mbrojtje janë jashtëzakonisht të forta. Nga viti 1992 është ndërtuar bashkëpunim i fuqishëm edhe në ekonomi edhe kulturë, ndërsa ky bashkëpunim do të avancohet dhe do të vazhdojë mbështetja nga Turqia për vendin tonë, veçanërisht në modernizimin dhe trajnimin e Armatës së Maqedonisë Veriore, kanë konkluduar në konferencën për media pas takimit të ministres të Mbrojtjes, Radmila Shekerinska, e cila dje ishte nikoqire e ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Turqisë, Huluisi Akar.

Ministri Akar, megjithatë paralajmëroi se struktura të organizatës të ashtuquajtur FETO, që ekzistojnë në Maqedoninë e Veriut, i dëmtojnë marrëdhëniet e të dy vendeve dhe i sabotojnë në një farë mënyrë edhe marrëdhëniet vëllazërore që i kemi. "I kemi emrat e disa prej më kryesorëve të organizatës terroriste, që janë ndarë mes institucioneve të dy vendeve dhe jam thellë i bindur se gjatë ditëve të ardhshme institucionet e Maqedonisë së Veriut do ta ndërmarrin masa konkrete rreth kësaj. U besoj institucioneve të Maqedonisë së Veriut", tha mes tjerash ministri Hulusi Akar dhe shfaqi shpresën se gjatë periudhës së ardhshme, do të bëjnë masa konkrete të çlirohen nga kjo organizatë terroriste. Ministrja Shekerinska shfaqi shpresën se në të ardhmen Turqia do ta ratifikojë Protokollin për inkuadrimin e vendit tonë në NATO dhe informoi se për dy muaj jo të plota nga procesi i nënshkrimit të Protokollit, tashmë nëntë vende anëtare të Aleancës e kanë ratifikuar, mes të cilave vendet e para fqinje anëtare të NATO-s. "Turqia është fqinji ynë i drejtpërdrejtë, por gjithmonë është sjellë më shumë se sa një fqinj, ishte këtu kur vendit tonë i duhej ndihmë dhe mbështetje dhe me këtë nuk e kemi harruar", theksoi Shekerinska. Sipas asaj, bashkëpunimi i suksesshëm në mbrojte shihet edhe në fushat më të vështira për bashkëpunim, ndërsa këto janë misionet jashtë vendit siç është në Afganistan, ku ushtarët tonë marrin pjesë në suaza kontingjentit turk, nënvizoi Shekerinska.

Për Turqinë, Republika e Maqedonisë së Veriut është jashtëzakonisht e rëndësishme, ndërsa lidhjet historike dhe kulturore janë shumë të fuqishme, deklaroi ministri i Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë, Hulusi Akar, duke shtuar se shumë i rëndësishëm është anëtarësimi i vendit në NATO, ndërsa në këtë rrugë vendi i tij do të vazhdoj me mbështetje të fuqishme.

Ministrat e Mbrojtjes informuan gjithashtu se në shkollat e larta dhe institucionet ushtarake në Turqi deri tani janë trajnuar mbi 1200 pjesëtarë të Armatës.

NË PËRFUNDIM SALLA E SPORTIT NË SHIPKOVICË

DREJT PËRFUNDIMIT URA NDËRMJET SHIPKOVICËS

Më 29 gusht të vitit 2016 nga ana e Armatës së Republikës së Maqedonisë u shkatërruan disa shkëmbinj në këtë pjesë të rrugës, por edhe kjo rezultoi pa sukses sepse menjëherë më pas nga vërshimet, e njëjta rrugë u bllokua disa herë. Ky aks rrugor është i vetmi që lidh fshatrat Brodec, Veshallë dhe Bozovcë me Tetovën

Koha — Urim HASIPI

Tetovë, 3 prill - Aktualisht janë duke u zhvilluar punët për ndërtimin e urës ndërmjet Shipkovicës dhe Brodecit. Kjo rrugë, vite me radhë, kur ka reshje bllokohet dhe bllokon shumë fshatra të Malësisë dhe komunikimin e tyre me qytetin e Tetovës. Nuk dhanë rezultat as përpjekjet e dy vite më parë, kur e njëjta rrugë u asfaltua. Sërish vërshimet e dëmtuan këtë rrugë dhe si alternativë e vetme që mos përsëritet bllokimi ishte ura. Ndërtimi i urës ishte edhe kërkesë e kamotshme e banorëve të Malësisë. Për ndërtimin e urës, mjetet janë siguruar nga ana e pushtetit qendror dhe Komunës së Tetovës. Në vendngjarje punët i inspektoi kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi.

"Në këtë vend është duke u ndërtuar një urë më e madhe, me një gjerësi prej 8 metrave dhe 12 metra gjatësi, po ashtu ka një thellësi më të madhe që të mundësojë kalimin e ujërave nën urë që të mos bllokohet. Investimi është mbi 8 milionë denarë, prej të cilëve 3.5 milionë denarë janë siguruar nga Byroja për Zhvillim Rajonal kurse pjesa tjetër është bërë nga ana e Komunës së Tetovës. Me ndërtimin e urës, shpresojmë se në të ardhmen kjo pikë nuk do të jetë problematike për qarkullimin e automjeteve", tha Teuta Arifi. Po ashtu në fshatin Shipkovicë është në përfundim e sipër edhe salla e sportit. Salla e sportit është në kuadër të Shkollës fillore "Rexhep Voka". Sipas kryetares së Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, pushteti qendror ka financuar sallën, ndërsa Komuna kanalizimin dhe rrjetin e elektrifikimit.

"Pjesa e brendshme e sallës është përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i saj. Komuna ka bërë rregullimin e kanalizimit, lidhjen në kanalizim, rrjetin elektrik, kurse punohet në pjesën e rrethimit të pjesës së parë", deklaroi Arifi. Në ndërkohë, në këtë fshat janë rregulluar edhe dy mure mbrojtëse, si kërkesë e banorëve për të parandaluar vërshimet që të shkaktojnë dëme më të mëdha. "Në hyrje të fshatit dhe në pjesën qendrore janë bërë dy mure mbajtëse, që kanë qenë një problemi banorëve, dhe kjo është bërë për të siguruar jetën e banorëve", theksoi ajo.

Kohëve të fundit, rruga Shipkovicë-Brodec është vend potencial që të ndodhë edhe ndonjë tragjedi më e madhe, sepse vërshimet në atë zonë janë të mëdha dhe të paparashikueshme, sidomos kur ka rreshje atmosferike ndërkohë që në atë rrugë qarkullojnë banorët e Brodecit, Veshallës dhe Bozovcës. Më 29 gusht të vitit 2016, nga ana e Armatës së Republikës së Maqedonisë u shkatërruan disa shkëmbinj në këtë pjesë të rrugës, por edhe kjo rezultoi pa sukses, sepse menjëherë më pas nga vërshimet e njëjta rrugë u bllokua disa herë. Ky aks rrugor është i vetmi që lidh fshatrat Brodec, Veshallë dhe Bozovcë me Tetovën.

Pas ndalimit edhe në Kosovë, Maqedonia do të shndërrohet në parajsën e bixhozit



Shkup, 3 prill - Autoritetet kosovare tashmë kanë ndaluar të gjitha format e basteve për periudhë prej dhjetë vitesh, pas vrasjes së dy të punësuarve në një kazino javën e kaluar. Në ndërkohë, vetëm për një natë janë mbyllur mbi 200 pika bastesh dhe kazino, ndërsa në vijim e sipër

"Nuk do të lejojmë që këto hapësira të jenë arena të krimit që marrin jetë njerëzish", ka deklaruar kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, transmeton Euronews. Haradinaj ka propozuar Ligj për ndalesë të lojërave të fatit pas dy vrasjeve, ndërsa deputetët e miratuan të enjten e kaluar. Ligji është futur në fuqi që nga dita e parë e muajit prill. Euronews shkruan se lojërat e fatit janë bërë problem i madh në Kosovë, një prej vendeve më të varfra në Evropë, ku të papunë janë rreth një e treta e popullatës së aftë për punë. Industria e lojërave të fatit është rritur shpejtë gjatë dekadës së fundit dhe deri tani aty janë punësuar rreth 4000 persona. Shumicën prej tyre i ka kapluar frika për vendet e tyre të punës pas ndalesës më të re.

Pas Shqipërisë kazinotë dëbohen edhe nga Kosova, ndërsa tani paralajmërohet se do të hapen kazino të reja në Maqedoni për nevojat e shqiptarëve dhe kosovarëve që do të vijnë të organizuar në Maqedoni që të vazhdojnë të provojnë fatin e tyre këtu.

KRONIKË

Gruaja denoncon burrin për sulm fizik

Banorja 31-vjeçare e një fshatit të Tetovës, të martën rreth orës 1 e 40 minuta ka denoncuar se është sulmuar fizikisht nga burri i saj. Burri pak më vonë është ftuar në stacionin policor të Tetovës dhe pas dokumentimit të plotë të rastit, kundër tij do të pasoj padi adekuate njofton policia e Tetovës.

Gjendet marihuanë në kulmin e burgut

Një i punësuar në burgun e Tetovës, të martën rreth orës 9.40 minuta, në Sektorin për punë të brendshme në Tetovë, ka denoncuar se në kulmin e magazinës ka vërejtur një qese të najllonit, në të cilën më vonë është vërtetuar se në të ka marihuanë. Qesja e najllonit është konfiskuar për analizë. Po ndërmeren masa për zbardhjen e plotë të rastit, njoton Sektori për punë të brendshme në Tetovë.

Një minahedhës dore gjendet në Tetovë

Të martën rreth orës 18.10 minuta, në një objekt të braktisur në rrethin e ish shtëpisë përmirësuese, në rrugën e "Lubotenit" në Tetovë, pjestarë të policisë nga Sektori për punë të brendshme në Tetovë kanë gjetur një minahedhës dore të kalibrit 64 milimetër M80, prodhim i ish Jugosllavisë. Është kryer hetim, ndërsa minahedhësi është konfiskuar nga përfaqësues të drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim.

Policia në aksion për kundërvajtjet në komunikacion

Të martën nga ora 8 deri në orën 13 në rajonin e Tetovës është realizuar një aksion kontrolli në komunikacion, me theks të veçantë për përparësinë e kalimit në komunikacion. Në këtë aksion kontrolli janë zbuluar gjithsejt 17 kundërvajtje, të cilat kanë të bëjnë me mos respektimin e përparësisë së kalimit, si dhe 5 kundërvajtje të tjera. Kundërvajtjet e konstatuara janë rombullaksuar me 8 sanksione adekuate për kundërvajtje si dhe 9 fletëpgaesa për gjobë.

(U.H)

EKSPORTET USHQIMORE

FORCA E INDUSTRISË USHQIMORE PO ZBEHET

Eksportet ushqimore vitin e kaluar arritën 319 milionë euro, por të dhënat nga Enti Shtetërorë i Statistikës tregojnë se importet po rriten shumë më shpejtë se eksportet, prandaj deficiti në tregtinë ushqimore po rritet çdo vit

Koha — Qefsere ABDYLI

Shkup, 3 prill - Humbjet, rritja e importeve, falimentimi në punë, gjendja e keqe në bujqësi, mungesa e infrastrukturës dhe problemet e transportit janë probleme kyçe që për vite të tëra e pengojnë zhvillimin e sektorit ushqimor në Maqedoninë e Veriut, ndonëse ka kapacitetet dhe burimet për të krijuar një industri ushqimore që do të jetë një nga shtyllat e rritjes ekonomike, por që është ende larg nga ajo, thonë ekspertët. Nëse nuk ndërmerren hapa konkrete për të mbrojtur prodhuesit maqedonas të ushqimit, do të arrijmë në varësi të importit, pasi varet nga importet e mishit dhe nga shumë produkte të tjera që mund të prodhohen në vendin tonë.

Kryetari i Shoqatës së fermerëve "Agrofalanga", Lupçe Stankovski, thotë se industria ushqimore është e lidhur ngushtë me prodhimin bujqësor në vend. "Nëse janë të disponueshme mjaft materiale të papërpunuara me një çmim të favorshëm, ajo do të zhvillohet dhe zgjerohet, pastaj do të inkurajojë bujqësinë për prodhimin më të madh, gjë që do të rrisë më tej profitabilitetin", tha Stankovski. Sipas tij, kjo në Maqedoninë e Veriut nuk është aspak, për shkak të korrelacionit të lartë të politikës me biznesin në lidhje të korruptuar, fermerët janë të gjithë në prodhim kaotik, të paorganizuar gjë që rezulton në furnizim të parregullt të industrisë ushqimore me materiale të papërpunuar cilësore me çmime të qëndrueshme.

Ai përmend se vetëm markat maqedonase që do të blihen nga kompanitë e huaja mund të mbijetojnë. "Nuk mund të dëshirojmë të hyjmë në Bashkimin Evropian me një prodhim të tillë jofitimprurës. Bullgaria, e cila kishte burime të mëdha të tokës, pësoi hyrje në BE dhe tani po lufton për të ruajtur prodhimin e saj dhe për të luftuar konkurrencën jo lokale nga BE. Gjatë një vizite në fermat në Bullgari vitin e kaluar, ishte simptomatike që asnjë fermë nuk ishte shitur në tregun e BE-së, por të gjitha shiten në tregun e brendshëm. Kishte lidhje me grumbullime të mëdha bujqësore, me mekanizma më të sofistikuar kompjuterike, të cilat priten të jenë konkurrent në tregun e BE-së", shpjegon Stankovski.

Gjithashtu, arsyeja për rritjen e importit të ushqimit përveç prodhimit të dobët vendas është vlera më e lartë e shtuar e produkteve që ne importojmë. "Duke konsideruar se një numër i madh i anëtarëve të CEFTA-s në prodhim kanë një avantazh të rëndësishëm konkurrues në raport me prodhuesit tanë, ato krijojnë mundësi për mallrat e importuara për të rritur praninë e tyre në tregun tonë, gjë që rrit importin si në sasi ashtu edhe në sasi vlerë", thotë Dragi Dimitrievski, profesor në Fakultetin e Shkencave Bujqësore dhe Ushqimit. Eksportet ushqimore vitin e kaluar arritën 319 milion euro, por të dhënat nga Enti Shtetërorë i Statistikës tregojnë se importet po rriten shumë më shpejtë se eksportet, prandaj deficiti në tregtinë ushqimore po rritet çdo vit.

"Nëse analizojmë strukturën e eksportit dhe importit të ushqimit, mbi 50% të eksporteve janë për shkak të frutave dhe perimeve të freskëta, ndërsa artikujt më të mëdhenj të importit janë mishi, drithërat, pemët, perimet dhe produktet e qumështit", tha Dimitrievski. Sipas tij problemi nuk duhet të gjendet vetëm në prodhimin primar, por edhe në industrinë përpunuese. Vendi ynë eksporton perime të freskëta dhe fruta, dhe pastaj konsumon miliona për të importuar të ngrirë apo të ruajtur. "Karakteri biologjik i prodhimit bujqësor pengon prodhimin e çdo gjëje që kërkon tregu, kështu që zakonisht janë produktet që nuk mund të prodhohen në kushtet tona klimatike-gjeografike që vijnë nga importi". Gjendja e industrisë ushqimore është shumë komplekse dhe nevojitet një strategji që do të bëjë lëvizjet tektonike në këtë sektor dhe që do të zgjidhte të gjitha problemet.

Rezultate serioze në uljen e borxhit publik

Shkup, 3 prill - Ministri i Financave, Dragan Tevdovski, mendon se janë bërë rezultate serioze në pjesën e uljes së borxhit publik. Sipas tij, borxhi publik është stabilizuar dhe është penguar që të rritet në të ardhmen. "Kemi realizuar rezultatet serioze. Nëse borxhi publik nga viti 2008 deri në vitin 2016 do të rritej prej diku 23 për qind nga BPV-ja në 48,8 për qind nga BPV-ja, në fund të vitit 2017 ka arritur 48,7 për qind. Absolutisht kemi rezultat të realizuar", deklaroi sot Tevdovski, duke u përgjigjur në pyetje të gazetarëve lidhur me raportin e rregullt pranveror të Bankës Botërore.

Nga Banka Botërore dje theksuan se borxhi publik në shtet tani është në nivel prej 49 për qind të BPV-së dhe duhet të zbatohet politika të cilat do të pengojnë rritjen e mëtutjeshme. "Maqedonia tani është në nivel të 49 për qind të BPV-së, që mund të thuhet se është nivel mesatar i borxhit, megjithatë ka shumë ekonomi në Evropë të cilat kanë borxh më të vogël të cilët mund më shpejtë të rriten, kështu që duhet të bëhet baraspeshë midis financave të qëndrueshme dhe në të njëjtën kohë gjetje të politikave të cilët do ta nxitin rritjen", deklaroi dje Sanja Magjaroviq Shujster, ekonomiste e lartë për BB-në në rajon.

Motoçiklistë kini kujdes dhe respektoni rregullat

Shkup, 3 prill - Mbani kaskë mbrojtëse, kini kujdes në shpejtësinë, përdorni sinjalet e kthimit, mbani distancë. përdorni të dyja frenat, evitoni "këndet e vdekura", mbani jelek reflektues dhe pajisje mbrojtëse, u bëjnë apel nga Këshilli Republikan për Siguri në Komunikacion të Rrugëve të gjithë motoçiklistëve, duke theksuar se ata janë edhe grupi më i rrezikuar në trafik, nëse merret parasysh sa pjesa e trafikut u takon atyre dhe sa është pjesëmarrja e tyre në numrin e përgjithshëm të personave të vdekur dhe të lënduar në aksidentet rrugore. Nga KRSKRR theksojnë se mesatarisht, në nivel vjetor në vend, rreth 15 motoçiklistë e humbin jetën në aksidente rrugore. "Motoçiklistët janë kategori e ndjeshme e pjesëmarrësve në trafik, drejtpërdrejt e ekspozuar në rreziqe që vazhdimisht janë në trafik dhe te e cila rreziku për marrje të lëndimeve vdekjeprurëse në rast të aksidentit rrugor është jashtëzakonisht i ulët" kanë potencuar nga Këshilli. KRSKRR në fillim të sezonit për motoçiklistë u bëjnë apel motoçiklistëve të kenë kujdes dhe të ndërgjegjshëm në trafik, t'i kenë kujdes rregullat për përkufizimin e shpejtësisë, të përdorin kaska dhe pajisje tjetër mbrojtëse për siguri pasive.

Angjushev siguron se do të realizohet rritja ekonomike

Shkup, 3 prill - Zëvendëskryeministri për Çështje Ekonomike, Koço Angjushev, konsideron se është e realizueshme rritja e planifikuar ekonomike prej 3.2 për qind për sivjet edhe krahas parashikimeve të Bankës Botërore se ajo do të arrijë 2.9 për qind, ndërsa pritjet, siç thotë, i bazon në faktet reale nga tremujori i parë. Në komentin e parashikimeve të djeshme të BB-së, Angjushev dje deklaroi se pret rritje të BPV-së në tremujorin e parë të këtij viti më të lartë nga rritja e projektuar mesatare të Qeverisë për të gjithë vitin.

"Është mirë që Banka Botërore është gjithmonë konservative. BB edhe për vitin 2018 parashikonte rritje nën 2,5 për qind, por ai përfundoi me 2,7 për qind. Planet dhe vëzhgimet tona janë se atë që e planifikojmë do ta realizojmë dhe mendojmë se do të jetë edhe më mirë. Këtë e bazojmë n. faktet reale nga tremujori i parë", deklaroi sot Angjushev, duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve. Sipas tij, prodhimi industrial, bujqësia dhe ndërtimtaria, që janë tre shtyllat kryesorë për gjenerimin e bruto prodhimit vendor në shtet, po zhvillohen edhe më mirë se e planifikuara. Prodhimi industrial në tremujorin e parë ka rritje të përafërt prej nëntë për qind, në janar të këtij viti në krahasim me janarin e vitit të kaluar është rritur për 12 për qind, në shkurt për 7,3 për qind, ndërsa trendi i njëjtë ruhet edhe në mars. Ndërtimtaria vetëm në suaza të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore në tremujorin e parë ka pasur realizim prej 850 milionë denarë, ndërsa sivjet kemi 300 për qind rritje, apo rreth 2,8 miliardë denarë në periudhën e njëjtë.

Pas vlerësimeve të paradokohshme për punën e Qeverisë nga ana e Odës Ekonomike Gjermane, zëvendëskryeministri sqaron se problemet zgjidhen në takime me afaristët të cilët para së gjithash kanë pasur vërejtje në pjesën e politikës tatimore dhe trarifave doganore për të cilat, thekson, ekziston hapësirë që të bisedohet, ndërsa do të duhet të bëhen me aderimin drejt BE-së.

Ngjitja historisë!

Nga
Nazim RASHIDI

Ky ishte lajmi: "Kryeministri grek Aleksis Cipras, pasdite në Kuvendin e Maqedonisë u takua me grupin e pavarur të VMRO DPMNE-së dhe koalicionit dhe i uroi tetë deputetët për vizionin dhe guximin, njoftuan nga grupi parlamentar.

- Na uroi për vizionin dhe guximin dhe theksoi se me hapa konkret, nga të cilat është edhe vizita e sotme historike, do të punojmë së bashku për të ndërtuar miqësi mes popullit maqedonas dhe grek – thonë nga grupi i pavarur i VMRO DPMNE-së dhe koalicionit".

Ky ishte një pjesë e lajmit. I cili vijoi edhe me këto fjalë: "Tetë deputetët të cilët votuan ndryshimet kushtetuese sipas Marrëveshjes së Prespës, Ciprasit i kishin shprehur pritshmëritë për Greqinë sa i përket integrimeve euroatlantike të shtetit, kurse ai iu ishte përgjigjur se jo vetëm që do të na mbështesë, por edhe do të angazhohet të jetë udhëheqës në këtë rrugë".

Lajmi ishte në shumë portale, unë e lexova tek lider.com për të qenë korrekt. Por më shokuese se këto fjalë, ishte foto që shoqëronte lajmin. Krsto Mukovski, i cili ia jepte dorën kryeministrit Cipras dhe rreth tij deputetët e tjerë "disidentë" siç e quajnë veten, të pavarur nga VMRO DPMNE dhe koalicioni. Foto sa një mijë fjalë, e cila në rrethana të tjera do të derdhej në vaj, e do të pikturohej sipas stilit klasik e do të varej në pallatin e bardhë të VMRO-së.

Por upsss, këta të tërë kanë qenë kundër, kundër shumë çkaje e gjithë çkaje, e sot shfaqen pa pikë droje, duke dashur të përlyhen nga historia. Mbase-mbase edhe për të thënë "kishim gabuar" tani jemi në anën e duhur të saj. Por jo... them se të gjithë e dinë pjesë të kujt ishin Elizabeta Kançeska-Milevska, Emilija Aleksandrova, Nola Ismajloska-Starova, Sasho Vasilevski, Luben Arnaudov, Zeqir Ramçiloviq, Vladanka Aviroviç dhe padyshim Krsto Mukovski.

Me gjithë përpjekjet që bëjnë, të gjithë e dinë se si erdhi dhe çfarë ndodhi që hapësit e dyerve të Kuvendit, më 27 prill, sot të shfaqen me një normalitet therës, e të flasin me patos për të ardhmen të cilin jo që se imagjinonin dot, por edhe e urrenin. Por, pse e përmend këtë lajm dhe këtë moment? Sepse, në anën tjetër, në Greqi, beteja për Marrëveshjen e Prespës bëhej për arsye parimesh e bindjesh. Mund të hymë në konspiracione të shumta, apo edhe me mungesë informacionesh, të mos e dimë dinamikën e zgjatjeve e tërheqjeve të politikës greke, por e vërteta e madhe është, se atje askush nuk duhej t'i shpëtonte burgut, dhe askush nuk votonte me presionet pas incidentesh të dhunshme në parlament. Gjithçka ishte brenda një dinamike politike e përplasjesh të mëdha edhe shoqërore, të shoqëruara edhe me protesta. Por bartësit e idesë i qëndruan deri në fund nismës së marrë.

> **Zgjidhja është tek përgjegjshmëria dhe politika e bazuar në politikanë me taban ideologjik që kupton se populizmat kanë afat të përkohshëm, se politika e bazuar në klientelizëm han vetveten, për arsye të thjeshtë e shumë humane: sepse njerëzit në fund duan mirëqenie dhe jetë paqësore. Po, kaq e thjeshtë është**

Cipras e tha edhe në Shkup, për shkak të një vizioni, të cilit i beson. Në programin e fundit të ftuar kisha ndër të tjera Sofia Christoforidou,redaktore pranë gazetës greke "Makedonia". Duke mos ndjekur edhe shumë reagimet dhe debatin në Greqi, ajo thotë se ende është shumë e vështirë për grekët, veçanërisht për ata që jetojnë në Maqedoninë greke, të përtypin faktin që persona të tjerë e quajnë veten "maqedonas". Christoforidou thotë se do të duhet kohë që të pranohet në Greqi realiteti që e shpalosin kryeministrat Cipras dhe Zaev. "Kur e dëgjuam kryeministrin Zaev të thotë "Unë jam maqedonas dhe miku im kryeministri grek" për shumë në Greqi ishte e vështirë ta përtypnim këtë", thotë ajo.

Marrëveshjes së Prespës i referohej si "plagë e hapur" për Greqinë, e cila që të shërohej do të duheshin vite, mbase dhe gjenerata. Imagjinoni betejën në anën tjetër nga Cipras dhe Siriza, që duhej të bënin, kundër një opinioni aq kundërshtues për të arrirë marrëveshjen. I përmend këto sepse duhet theksuar se dy anët e medaljes të marrëveshjes janë të ndryshme. Dhe dallimi

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Koha
Epërditshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Sloboden Pecat" - rr. Kej 13 Noemvri nr.3/1-238, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë, 3 prill 2019 | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

është se këtu një shumicë më e madhe, mundohet t'i ngjitet asaj që duket një "sukses historik". E vërteta është se shumë më pak besonin në këtë sukses dhe aq më pak mendonin se do të arrihet, por thuajse me gishta ishin ata që e morën guximin ta zbatojnë, kurse tani edhe më kundërshtuesit ngjiten pas suksesit.

Jo, të nderuar, kjo s'duhet pranuar lehtë. Por më shumë se kaq, nga gjithë ky episod, "historik" ose jo, duhet mësuar. E mësimi është bazik. Se në politikë megjithatë gjithçka buron tek një besim parak i veprimit politik, tek një ideologji politike, e cila duhet të jetë shtysa për veprim. Cipras këtë e ka pasur në kontinuitet. Kritikët e tij e akuzojnë për "tradhti" ndaj majtizmit që ka pasur. Edhe ai vetë mbase është dashur të bëjë kompromise me ideologjinë për shkak të realitetit ku vepronte, por sërish tharmi i bindjeve të tij aty janë. Kjo i reflektohet në fjalime, në artikulim, në vizionin që e shpreh, por edhe në veprim. A do të jetë një politikan që do të mbahet mend për mirë, këtë më së miri do ta vlerësojnë grekët. Gjasat janë se do humbë në zgjedhjet e ardhshme. Që tregon se gjithë barrën e Marrëveshjes së Prespës e bërë me riskun e humbjes. Por sërish, në raste të tilla distanca kohore do të jetë gjykues më real. Si do që të jetë esenca e bindjeve politike, ka ndikuar në veprimin e tij dhe kjo duhet pranuar. Por, sa tharm ideologjik kishte në Maqedoninë e Veriut, gjatë vendimeve të mëdha.

Realisht, përshtypja është se shumë parti e politikanë iu ngjitën trenit për shkak të trendit, e jo për shkak të besimit ideologjik. Nga ana tjetër, Kryeministri Zaev vazhdimisht thotë se jam i majtë, dhe mbase edhe besimi i tij për suksesin e procesit vjen edhe nga kjo ideologji. Por mësimi i madh duhet të jetë tek modernizimi i politikës dhe pa diskutim, pa diskutim ikja nga populizmi. Veç imagjinoni tani sa çdo të ndodhte nëse procesi do të dështonte dhe çfarë artilerie do të përdornin armiqtë e politikës të secilit kryeministër.

Sa pak duhej që selfie i djeshëm historik të shndërrohej në një dramë tragjike greke e ballkanike. Prandaj zgjidhja është tek përgjegjshmëria dhe politika e bazuar në politikanë me taban ideologjik që kupton se populizmat kanë afat të përkohshëm, se politika e bazuar në klientelizëm han vetveten, për arsye të thjeshtë e shumë humane: sepse njerëzit në fund duan mirëqenie dhe jetë paqësore. Po kaq e thjeshtë është.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

Marksizmi në epokën e pabarazisë globale

Nga
Gwynne DYER

"Karl Marksi kishte të drejtë: socializmi funksionon. Ka gabuar vetëm për specien", ka shkruajtur sociobiologu E.O. Uilson, autoritet për botën e milingonave. Por realiteti është pak më i komplikuar se kaq, dhe kjo është një kohë e mirë për të folur për këtë. Marksi vdiq në mërgim në Londër më 1883 dhe nuk mund të fajësohet për dhjetëra miliona njerëz të vrarë në emër të marksizmit në Bashkimin Sovjetik, Kinë dhe tjetërkund, gjatë shekullit të njëzetë. Por Marksi me të vërtetë donte të ndryshonte botën, dhe qëllimi i tij ishte barazia: një "shoqëri pa klasa".

Në momentin e forcës së vet më të madhe, në mesin e viteve tetëdhjetë, marksizmi mbizotëronte në jetën e një të tretës së banorëve të botës. Sot është ideologjia zyrtare e vetëm pesë vendeve, dhe madje në këto raste është mbi të gjitha një justifikim për regjimet autoritare, jo një sistem real vlerash. Por parimi i barazisë mbetet një vlerë qendrore në politikën e qenieve njerëzore, dhe sot dimë pak a shumë arsyen përse.

KTHESAT E QYTETËRIMIT

Egalitarizmi midis qenieve njerëzore përbën një problem, që antropologu Bruce Knauft e quajti "kthesa në formë U-je". Knauft vuri në dukje se të gjitha speciet e primatëve jo-njerëzorë, të tilla si shimpanzetë, gorillat, etj, janë thellësisht hierarkike (linja vertikale), ndërsa deri në njëqind mijë vjet para ardhjes së qytetërimit, paraardhësit tanë gjahtarëmbledhës, ishin shumë egalitarë (në vijë horizontale).

Por me ardhjen e qytetërimeve në masë, pesë mijë vjet më parë, janë kthyer të dominojnë vlerat e shimpanzeve: kështu, deri jo shumë kohë më parë, të gjitha shoqëritë e qytetëruara ishin hierarki, të bëra nga privilegji dhe pushteti. Prej këtu është tërhequr një vijë tjetër vertikale, dhe si pasojë, kthesa në formë U-je. Kjo ngre dy pyetje: si qeniet njerëzore e hoqën qafe normën e primatëve, dhe pse lëshuan sërish, kur u bënë "të civilizuar"? Përgjigja më e mirë për pyetjen e parë vjen nga antropologu Christopher Boehm, sipas të cilit njerëzit kanë qenë mjaftueshëm të zgjuar, për të kuptuar se lufta e zakonshme për dominim midis të gjithë primatëve meshkuj, mund të ketë vetëm një fitues.

Të tjerët ishin të dënuar për të qenë të mposhtur, si dhe për t'u poshtëruar dhe nënshtruar nga mashkulli dominues. Duke qenë se çdo individ kishte më shumë gjasa për të humbur se sa për të fituar, ishte në interes të përbashkët për t'i dhënë fund të gjithë lojës së dominimit - dhe për shkak se ndryshe nga primatët e tjerë, njerëzit zotërojnë gjuhën, kjo lejoi ata të kurdisnin minirevolucione, që arritën pikërisht atë qëllim. Të gjitha këto shoqëri të vogla të gjahtarëve ishin egalitare sepse verponin, siç shkruante Boehmi, në "hierarkitë e dominimit të kundërt": anëtarët e zakonshëm ishin aleate me njëri-tjetrin dhe kishin nënshtruar meshkujt alfa potencialë. Edhe sot, traditat e shoqërive aborigjene pasqyrojnë këtë revolucion të vjetër: ata janë egërsisht egalitarë dhe zotërojnë mekanizma të fuqishëm shoqërorë, për t'ua ulur kokën këtyre, kur e ngrenë më shumë se sa duhet.

Pse kanadezët zgjodhën Justin Trudeau si kryeministër, ndërsa amerikanët zgjodhën Donald Trump si president të tyre? Të dy vendet kanë kultura të ngjashme dhe të ardhura pothuajse identike për frymë, por 20 për qind e të pasurve kanadezë fitojnë 5.5 herë më shumë se 20 për qind e më të varfërve. Në Shtetet e Bashkuara, një e pesta më e pasur e popullsisë fitojnë tetë herë më shumë se një e pesta e të varfërve. Pabarazia është e pashmangshme, por duhet të menaxhohet

Qeniet njerëzore kanë jetuar në grupe të vogla pa hierarki, pa as një udhëheqës formal, mjaft kohë, aq sa për të përfshirë këto vlera egalitare në kulturën tonë dhe ndoshta në gjenet tona. Por edhe qytetërimet më primitive ishin të shumta dhe kjo i kishte anulluar mekanizmat e kontrollit shoqëror, të bazuara në identifikimin dhe pengimin e meshkujve potencialë alfa. Për më tepër, shoqëritë e mëdha zotëronin ekonomi të ndërlikuara, që kërkonin procese të centralizuara të vendimmarrjes. Dhe kështu meshkujt alfa kanë marrë kontrollin, duke shkaktuar mijëvjeçarë të tërë tiranie. Kjo gjë përfundoi vetëm gjatë dy shekujve të fundit, kur revolucionet demokratike filluan t'i përmbysnin mbretërit, perandorët dhe diktatorët. Por pse pikërisht në atë moment?

Ndoshta sepse rritja e mediave (në një fazë të parë vetëm gazetat e shtypura dhe edukimi masiv) u ka rikthyer miliona njerëzve, aftësinë për t'u organizuar dhe sfiduar ata që i kanë dominuar.

MENAXHIMI I PABARAZISË

Shpirti egalitar nuk kishte vdekur brenda tyre dhe kështu ata shfrytëzuan mundësinë. Sot më shumë se gjysma e popullsisë së botës jeton në vende që janë pak a shumë demokratike. Por kjo është vetëm barazia politike. Ne kurrë nuk kemi rizbuluar barazinë materiale të gjahtarëve-grumbulluesve, dhe hierarkitë sociale vazhdojnë. Qëllimi i Marksit ishte që të rimerrej terreni i mbetur i humbur (edhe pse ai kurrë nuk e kishte thënë kështu) dhe për të krijuar një shoqëri pa klasa, që jetonte në barazi absolute. Ishte një qëllim kaq joshës, sa që miliona njerëz dhanë jetën e tyre për të, por ishte një fantazi.

E vetmja mënyrë për të arritur këtë lloj barazie përsëri në një shoqëri moderne masive ishte zbatimi i kontrollit të rreptë social - dhe të vetmit njerëz të aftë për të kryer një kontroll të tillë ishin diktatorët e pamëshirshëm. Rrëzimi i komunizmit na ka mësuar diçka: Barazia absolute ka çmim shumë të lartë. Por edhe një pabarazi e madhe e ka një çmim. Njerëzit që jetojnë në shoqëritë bashkëkohore demokratike mund të pranojnë shumë pabarazi, veçanërisht nëse ekziston një shtet social mjaft i zhvilluar, për të mbrojtur të varfrit. Megjithatë, kur dallimet e të ardhurave bëhen shumë të larta, politikat e qeverisë bëhen të shëmtuara.

Pse kanadezët zgjodhën Justin Trudeau si kryeministër, ndërsa amerikanët zgjodhën Donald Trump si president të tyre? Të dy vendet kanë kultura të ngjashme dhe të ardhura pothuajse identike për frymë, por 20 për qind e të pasurve kanadezë fitojnë 5.5 herë më shumë se 20 për qind e më të varfërve. Në Shtetet e Bashkuara, një e pesta më e pasur e popullsisë fitojnë tetë herë më shumë se një e pesta e të varfërve. Pabarazia është e pashmangshme, por duhet të menaxhohet.

(Internazionale)

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

Infeksionet, shkaktarë të sulmeve në tru dhe zemër

Infeksione të tilla si inflamacioni i mushkërive dhe infeksionet e traktit urinar mund, në një periudhë prej tre muajsh pas infektimit, të rrisin rrezikun e sulmit në zemër ose goditje ishemike, sugjeron një studim i ri. Rreziku i zemrës dhe i sulmit në tru ishte më i lartë në dy javët e para pas infektimit.

Infeksionet shkaktojnë një reaksion inflamator në trup, kështu që shkakton prodhimin e qelizave të bardha të gjakut për të ndihmuar në largimin e infeksionit, por ky proces rrit adezionin e trombociteve dhe çon në mpiksjen e gjakut që mund të bllokojë rrjedhjen e gjakut në zemër ose tru. Sa më i rëndë të jetë një infeksion, edhe më i fuqishëm është përgjigja inflamatore ndaj tij, gjë që rrit rrezikun e ngjarjeve kardiovaskulare, thonë ekspertët.

Duhet theksuar se lidhja mes infeksionit dhe kardiakëve, dhe sulmit në zemër ose në tru ka të bëjë me të gjitha llojet e infeksioneve, jo vetëm inflamacion të mushkërive apo atyre urinare.

GURËT NË TËMTH DHE YNDYRAT E LARTA, RREZIK PËR PANKREATIT AKUT

Ndër shkaqet kryesore në përkeqësimin e shëndetit të pankreasit, kësaj gjëndre që prodhon hormone dhe enzima që janë të nevojshme për balancimin e sheqerit në gjak dhe për procesin e tretjes së ushqimeve, në 80-90% të rasteve janë gurët në tëmth, yndyrat e larta, konsumimi i alkoolit, e deri te më seriozet, tumor

Një dhimbje shumë e fortë e lokalizuar në zonën epigastrike ose të stomakut e cila përhapet në formë brezi dhe irradohet në shpinë. Zakonisht ndodh pas abuzimit me alkool ose pas ngrënieve të bollshme të pasura me yndyra. Në shumë raste pacienti mund të ketë të vjella ose temperaturë. Të gjitha këto shenja flasin për pankreatit akut, një inflamacion, ënjtje e pankreasit. Është një situatë tepër serioze, që mund të çojë deri në vdekje, ndaj ka rëndësi diagnostikimi në kohë dhe mjekimi korrekt. Ndër shkaqet kryesore në përkeqësimin e shëndetit të pankreasit, kësaj gjëndre që prodhon hormone dhe enzima që janë të nevojshme për balancimin e sheqerit në gjak dhe për procesin e tretjes së ushqimeve, në 80-90% të rasteve janë gurët në tëmth, yndyrat e larta, konsumimi i alkoolit, e deri te më seriozet, tumor. Për këtë arsye përballë problemeve shëndetësore, nuk duhen neglizhuar konsultat mjekësore me mjekun gastrohepatologe, e cila në çdo rast nisur nga shqetësimet tuaja, kryen ekzaminimin përkatës për vendosjen e diagnozës.

ÇFARË ËSHTË PANKREASI? Pankreasi është një organ që lokalizohet në pjesën e majtë të kavitetet abdominal (hipokondër sinistër) nën stomak. Së pari, pankreasi është një gjëndër që prodhon hormone dhe enzima që janë të nevojshme për balancimin e sheqerit në gjak dhe për procesin e tretjes së ushqimeve. Është një gjëndër e traktit tretës e cila ka një funksion të dyfishtë, ekzokrin (duke prodhuar lëngun pankreatik që merr pjesë në tretje) dhe endokrin (duke sekretuar dy hormone antagoniste, insulinën, që është një hormon hipoglicemiant, dhe glukagonin që është një hormon hiperglicemiant.

PO PANKREATITI AKUT, SI MUND TË ZBULOHET? Sëmundjet më të shpeshta që prekin atë janë pankreatitet dhe kanceri i pankreasit. Pankreatiti është një inflamacion i gjëndrës së pankreasit. Ai mund të jetë akut ose kronik në rastet kur përsëritet. Pankreatiti akut është një dramë abdominale çka nënkupton që është një situatë tepër serioze, që mund të çojë deri në vdekje, ndaj ka rëndësi diagnostikimi në kohë dhe mjekimi korrekt.

ÇFARË NDIKON NË PËRKEQËSIMIN E SHËNDETIT TË PANKREASIT? Shkaqet më të shpeshta të tij janë prezenca e gurëve ose e llumit në tëmth, përdorimi dhe abuzimi me alkool dhe hiperlipidemia çka nënkupton yndyrat e larta në gjak. Në pankreatitin akut pacienti ndien një dhimbje shumë të fortë të lokalizuar në zonën epigastrike ose të stomakut e cila përhapet në formë brezi dhe irradohet në shpinë. Zakonisht ndodh pas abuzimit me alkool ose pas ngrënieve të bollshme të pasura me yndyra. Gjithashtu mund të kenë të vjella ose temperaturë.

KUR DUHET KËRKUAR NDIHMË PRANË MJEKUT DHE SI VENDOSET DIAGNOZA? Diagnoza e pankreatiteve vihet duke u nisur së pari nga shenjat klinike që prezantohen, në ekzaminimin objektiv të të sëmurit, analizat laboratorike ku shikohet një rritje e enzimave pankreatike në gjak, yndyrat e larta, leukocitet e larta në gjak etj. Gjithashtu për diagnozë ndihmon ekografia ku shikohet ndryshim i strukturës së pankreasit ,prezenca e gurëve dhe llumit në tëmth e në rastet e rënda dhe prezence e likidit abdominal. Gjithashtu për diagnozën ndihmon skaneri e rezonanca magnetike.

CILAT JANË TRAJTIMET E DUHURA DHE A JANË TË KUSHTUESHME? Për sa i përket trajtimit ai është spitalor. Së pari, ndërpritet ushqyerja nga goja në mënyrë që të lihet e qetë gjëndra e pankreasit dhe vendoset ushqyerja parenterale. Jepen enzima pankreatike nga goja dhe antibiotikë. Në rastet e ndërlikuara trajtimi mund të jetë kirurgjikal. Për ta parandaluar rekomandohet ushqyerje me kufizim të yndyrave kryesisht shtazore, mos abuzim me alkool, mjekim i hiperlipidemisë, kryesisht trigliceridëve. Gjithashtu për personat me gurë në tëmth rekomandohet heqja e tëmthit, pasi është parë që kolecistektomia e ul riskun që pankreatiti të përsëritet.

Qumështi i bletës, ilaçi i mrekullive

Qumështi i bletës është "ilaçi i mrekullive", pasi ka efekte kuruese për të gjitha moshat dhe shëron disa nga sëmundjet që vuajnë pjesa më e madhe e popullsisë

Ai ka efekt qetësues dhe çlodhës, ul nivelin e hormoneve të tiroides, ndihmon zhvillimin dhe rritjes, stimulon gjëndrat seksuale, ndihmon prodhimin e vezoreve gjatë shtatzënisë, duke rritur nivelin e progesteronit në gjak. Gjithashtu, qumështi i bletës rrit nivelin e testosteronit në gjak, duke ndihmuar në problemet e potencës mashkullore, stimulon gjëndrat mbiveshkore, ndihmon në sëmundje si artriti ose lodhja kronike, ul zmadhimin e prostatës.

Ka të njëjtin efekt si hormonet femërore, normalizon punën e testikujve, ndihmon në funksionimin e mëlçisë dhe sëmundjet e saj, rigjeneron strukturën e mëlçisë. Ka efekt antiinflamator (si Paracetamoli, Advili), pastron organizmin nga toksinat, ndihmon funksionimin e veshkave, rrit jetëgjatësinë e njerëzve duke ruajtur rininë e enëve të gjakut, zgjeron enët e gjakut, ndihmon në uljen e kolesterolit dhe trigliceridëve, rrit imunitetin. Ndërkohë, qumështi i bletës ndihmon edhe në formimin e rruazave të kuqe të gjakut dhe këshillohet në rastet e anemisë. Por, gjen përdorim edhe në kozmetikë, sepse ndihmon në pastrimin dhe rinimin e lëkurës. Përdoret si agjent antibakterial dhe antivirusal lokal për problème të ndryshme të lëkurës, ndërsa te fëmijët e sapolindur ndihmon në rritjen në peshë. Kura duhet të zgjasë një muaj, maksimumi tre muaj, për dozat lexoni me kujdes letrat që e shoqërojnë dhe respektoni indikacionet e shkruara. Rezultatet e kurës mund të shfaqen menjëherë ose me pak vonesë, sepse ndryshe nga poleni, qumështi i bletës vepron më ngadalë.

KUR NUK DUHET TË PËRDORET. Qumështi i bletës nuk duhet të përdoret në kriza astme, sepse mund të ngushtojë bronket, gjë që do ta rëndonte sëmundjen. Gjithashtu, nuk duhet ta përdorin ata që vuajnë nga sëmundja Addison, si dhe ata që kanë kancer në fazë akute. **EFEKTET ANËSORE.** Dhembje stomaku, të vjella, diarre dhe pagjumësi (kjo e fundit ndodh më shpesh te femrat). Në të tilla raste, në fillim ulni dozën dhe nëse efektet anësore nuk përmirësohen, ndërprisni konsumimin. Kujdes, nëse nuk respektoni dozat, mund të jetë helmues! Duhet pasur kujdes në përdorim kur organizmi është tepër i dobësuar, është e pamundur tretja e qumështit. Kur vuani nga sëmundje me spazma të tubit tretës, kancer shumë të përhapur në lëkurë.

REKA PËR REPUBLIKËN
BLERIM REKA PËR PRESIDENT
VOTO
1
blerimreka.org
#EuReka

BORXHI PUBLIK RREZIKON TA ÇOJË KOSOVËN DREJT KRIZËS

Banka Botërore në Kosovë ka paralajmëruar Qeverinë se borxhi i publik në Kosovë deri në vitin 2025, mund të arrijë vlerën deri në 30 për qind të Bruto Produktit Vendor, nëse rritja e shpenzimeve rrjedhëse vazhdon të tejkalojë rritjen e të hyrave.

Borxhi i përgjithshëm publik i Kosovës në fund të vitit të kaluar kishte arritur në rreth 1.1 miliard euro ose 17 për qind e Bruto Produktit Vendor. Nga borxhi i përgjithshëm, sipas një raporti të Ministrisë së Financave, rreth 700 milionë euro i takonë borxhit të brendshëm, kurse më shumë se 400 milionë euro i përket borxhit ndërkombëtar. Borxhi publik në Kosovë ndër vite ka shënuar rritje. Në vitin 2014, vlera e borxhit të përgjithshëm ka qenë 582 milion euro, kurse tri vjet pas, në vitin 2017 kjo vlerë ka arritur në rreth një miliard euro. Rrezikun nga ngritja e shpejtë e borxhit të përgjithshëm publik e theksojnë edhe ekspertë të çështjeve ekonomike. Shqetësues, sipas tyre, është fakti se rritja e borxhit publik mund të rezultojë nga faturat e pagave, transfereve dhe skemave sociale.

Lekë Musa, ish drejtor ekzekutiv në Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë, thotë për Radion Evropa e Lirë se nga koalicioni qeverisës aktual, por edhe nga qeveritë e kaluara, është rritur tendenca e keqpërdorimit të mjeteve buxhetore për arsye politike dhe partiake. Dhe nëse një situatë e tillë vazhdon, sipas tij, kriza buxhetore është e pashmangshme dhe e vetmja mundësi mbetet huamarrja përmes borxheve ndërkombëtare.

Se Kosova nuk mund të jetë imun nga rreziku i rritjes së borxhit të jashtëm, thotë edhe eksperti për çështje ekonomike Naim Gashi. Ai e konsideron të papranueshme mënyrën e shpenzimeve buxhetore për paga, mëditje dhe skema sociale, çka sipas tij, mund të rrisin edhe vlerën e borxhit publik.

"Absolutisht, është e papranueshme që një ekonomi nacionale dhe një vend me Bruto Produktin Vendor që është nën 7 miliardë euro në vit, të ketë një kosto kaq të lartë për shpenzime, paga dhe për projekte sociale, këtu bëjnë pjesë edhe veteranët e luftës dhe skemat të tjera enorme të cilat ekonomia e Kosovës me nivelin aktual të zhvillimit do të mund të përballojë", tha ai. Në raportin e Bankës Botërore të publikuar të martën në Prishtinë, thuhet se rreziqet fiskale për këtë periudhë janë Ligji i ri për pagat publike dhe rritja e shpenzimeve të pashënjestruara për mbrojtje sociale. Deri në vitin 2025, sipas raportit, borxhi publik dhe garancionet mund të arrijnë 30 për qind të Bruto Produktit Vendor nëse rritja e shpenzimeve rrjedhëse vazhdon të tejkalojë rritjen e të hyrave.

Në Ligjin për borxhet publike në Kosovë thuhet se në asnjë rast shuma e papaguar e borxhit të përgjithshëm, nuk duhet të tejkalojë 40 për qind të Bruto Produktit Vendor.

Se brezat e ardhshme do të ballafaqohen me faturën e borxhit publik të krijuar nga shteti i Kosovës, thotë edhe Lekë Musa, sipas të cilit, rritja e borxhit të jashtëm tregon perspektivën jo të mirë ekonomike në vend.

Borxhi i përgjithshëm është tërësia e borxhit shtetëror dhe komunal. Ky borxh merret në emër të institucioneve qendrore qeveritare, të cilin Republika e Kosovës është e obliguar ta paguajë.

(Kallxo.com)

RAMA: ASNJË PAZAR ME BASHËN

Kryeministri Edi Rama i bëri të qartë opozitës jashtë parlamentit se në asnjë rast nuk do të pranojë të negociojë me Lulzim Bashën për tu rikthyer në kuvend përmes pazareve.

"Nuk do t'ua japim më atyre këtë mundësi për tu futur në lojë. S'ka negociata. Kjo sepse Basha mori zotimin që përkundër ministrisë së brendshme, financave shëndetësisë, arsimit drejtorisë së OSHEE, legalizimit etj, do pranonte verdiktin e sovranit. Dhe jo më bojë e zezë për Shqipërinë. Kaq i kërkuam ne. I dhamë gjysmën e qeverisë. I kanë humbur zgjedhjet me qeverinë tuaj."

"A ka shqiptar që mund të besojë se ne që mundëm Saliun me gjithë ata që janë dëshmorë të reformimit të PD së Lulzimit, kur Saliu kishte shtetit, e kur nuk nxirrnim dot votën tonë nga kutia., u dashka të blejmë vota për të mundur Lulin? E mundëm Saliun me gjithë shtetin e tij në 2007, edhe në 2011. E mundëm në 2013 dhe në 2015. Tani si mundëm Saliun me Jozin etj, e jo më Lulin dhe Gaz Salianjin dhe Ervin Dumen? Kujt ja thonë këta që vota u vodh?

"Ata mendojnë se ndërkombëtarët do vijë një moment e do lodhen. E tani kanë filluar të artikulojnë idenë e ilegjitimitetit të deputetëve që kanë ardhur këtu."

Por ata kërkojnë sot një zgjidhje që të rihapet rruga që ata të vijnë sërish këtu. Nuk kemi për ti hapur kurrë rrugë kësaj zgjidhjeje. Ata që ikën e braktisë nuk do kthehen në asnjë lloj pazari., nuk ka për të ndodhur. E dyta zgjedhje të parakohshme se tani na ka mbetur fallxhorja pa rrogë, nuk ka.

Rama sqaroi se reformën elektorale e vunë si kusht për negociatat partia demokratike dhe forcat simotra të saj në Europë. Kryeministri u shpreh i gatshëm të plotësojë të gjitha rekomandimet e OSBE-ODIRH, por nuk do presë pa fund opozitën. *(Vizion Plus)*

PALOKA: DO JEMI NË SHESH DERI NË LARGIMIN E RAMËS

Opozita ka mbyllur protestën pas afro tre orësh. Protestuesit pas djegies së "piramidës së krimit" para Kryeministrisë marshuan drejt selisë blu. Në mungesë të liderit demorkat, Lulzim Basha ishte nënkryetari I kësaj force, Edi Paloka ai që ka mbajtur fjalën mbyllëse. Paloka tha se protesta e kësaj të mërkure u udhëhoq nga studentët dhe se këta të fundit ishin balli dhe zemra e saj. Ai theksoi se opozita do të jetë e shesh per te protestuar deri në largimin e kryeministrit Edi Rama nga qeverisja.



Një punonjës në Shqipëri dhe Ballkan kalon në dembelizëm 20-30 vite të jetës së tij produktive

Një punonjës në moshë pune (15-65 vjeç) në Shqipëri dhe në Ballkan harxhon në dembelizëm të plotë 20-30 vite të jetës së tij. Përllogaritjen e ka bërë Banka Botërore në Raportin e rregullt Ekonomik për Rajonin e Ballkanit Perëndimor që u prezantua sot. Në Rajonet e tjera ky tregues është më i ulët.

Banka vëren se në Ballkan njerëzit në moshë punë preferojnë të vegjetojnë, duke mos u përfshirë në tregun e punës për periudha të gjata kohe. Vitet e fundit pjesa e njerëzve që nuk dëshirojnë të punojnë ka rënë, por gjithsesi mbetet shumë e lartë. Madje në disa vende të Ballkanit të tilla si Kosova, papunësia raportohet në rënie pikërisht për shkak se njerëzit nuk duan të punojnë dhe për rrjedhojë as nuk raportohen si të papunë.

Por nga ana tjetër tregjet e punës në Ballkan përballen me mungesa. Kosova dhe Serbia kanë raportuan mungesa në sektorin e IT, ndërsa ne Shqipëri, Bosnje dhe Herzegovinë dhe Maqedoninë Veriore ka mungesë mjekësh.

Mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar është përkeqësuar nga emigrimi i vazhdueshëm i njerëzve me arsim të lartë. Potenciali i emigrimit në Vendet e Ballkanit Perëndimor mbetet i fortë. Gjermania mbetët vendi më i madh i destinacionit të emigrantëve nga Ballkani Perëndimor, duke tërhequr njerëz të diplomuar, nga e gjithë rajoni.

Ekspertët e Bankës Botërore lajmërojnë se shoqëritë e Ballkanit Perëndimor duhet të jenë më të mirë-përgatitura për të shfrytëzuar mundësitë që vijnë nga ndryshimet e shpejta në teknologji dhe për të krijuar ekonomi dinamike ku të rinjtë të kenë sukses dhe të realizojnë aspiratat e tyre.

Në disa qytete turke kandidatë të Partisë Republikane (CHP) arritën fitore. Po çfarë partie është kjo?

ÇFARË PARTIE ËSHTË CHP NË TURQI?

Cumhuriyet Halk Partisi (CHP) - në përkthim: Partia Popullore Republikane - u themelua në vitin 1923 nga themeluesi i shtetit turk, Mustafa Kemal Atatürk. Ajo është partia e parë, më e vjetra dhe më e suksesshmja parti e vendit. Asnjë parti tjetër nuk ka marrë më shpesh pjesë në qeveri. Deri në vitin 1945 ajo madje ishte e vetmja parti në Turqi. Profili i partisë bazohet në të ashtuquajturat "gjashtë shigjeta", që përfaqësojnë edhe logon e partisë. Republikanizmi, laicizmi, reformizmi (modernizimi), etatizmi, populizmi (Sovranitet i popullit/Demokraci), si dhe nacionalizmi janë deri sot aspektet qendrore të "ideologjisë kemaliste", të cilat do t'i ruajë dhe mbrojë CHP-ja.

Në vitet gjashtëdhjetë, CHP u hap edhe për vlerat socialdemokrate. Që atëherë, këtë parti mund ta shohësh si parti simotër të partisë socialdemokrate gjermane, SPD. Ajo ka qëndrim miqësor ndaj Evropës dhe e sheh një anëtarësim të Turqisë në Bashkimin Evropian si një hap të nevojshëm për modernizim. Në tërësi, CHP ka një qëndrim pozitiv ndaj Evropës dhe Perëndimit. Themeluesi i partisë Atatürk e vazhdoi përshtatjen osmane të vonë ndaj Perëndimit dhe reformoi drejtësinë, ekonominë, ushtrinë dhe politikën sipas modelit të shteteve evropiane. CHP ka një klientelë shumë më të shkolluar dhe me të ardhura më të larta se partia islamiste-konservatore AKP, e cila si tendencë i drejtohet popullatës më të paarsimuar të fshatrave. Mbështetës ose simpatizantë të CHP kishin për dekada pozicione të rëndësishme në drejtësi, ushtri, arsim dhe kulturë. Në këtë mënyrë u ndienë të denigruar turqit fetarë dhe fshatarë. Kemalizmi perceptohej nga kjo shtresë e popullatës si antifetar dhe që donte të prishte traditat ekzistuese. Për shembull, Kemal Atatürku i ndaloi që të mbahen në godina publike qeleshen dhe shaminë tradicionale të kokës, që në Turqi quhen Fes. Presidenti turk Recep Tayyip Erdogan dhe partia e tij, AKP mundën të nxjerrin kapital nga kjo atmosferë.

Ndikimi i CHP-së ra shumë pas fitores së parë në zgjedhje të AKP-së në vitin 2002. Që atëherë, kjo parti pas AKP-së është gjithnjë në pozitë më të disfavorshme. Rivalja konservatore ka arritur madje që në shumicën e zgjedhjeve parlamentare të sigurojë shumicën. Kjo bëri që në njëzet vitet e shkuara të niste një ndryshim pushteti dhe ndryshim kulturor që përfshiu gjithë shoqërinë. Erdogani e konsolidoi pushtetin, duke e zëvendësuar elitën e vjetër kemaliste, veçanërisht në medie, drejtësi dhe në ushtri, me një elitë të re konservatore. Rivaliteti midis CHP dhe AKP-së pra është më tepër se i natyrës politike. Partitë veprojnë si të thuash si kundërpole në një luftë kulturore.

PARTIA E ERDOGANIT KËRKON RINUMËRIMIN E VOTAVE NË STAMBOLL

Partia e Drejtësisë dhe Zhvillimit e presidentit turk Rexhep Taip Erdogan pasi për herë të parë pas 25 vjetëve e humbi kontrollin politik në Stamboll, kërkoi rinumërimin e votave nga zgjedhjet lokale në Stamboll, ndërsa si arsye për kërkesën i ka potencuar "parregullsitë" dhe "llogaritjen e gabuar" në procesin me të cilin qeveria e ka mbikëqyrur dhe me vite e kontrolluar. Gazeta britanike "Indipendent" transmeton se AKP ka kërkuar edhe rinumërimin e votave të disa rajoneve në Ankara në të cilën gjithashtu ka humbur me dallim të konsiderueshëm. Erdogani, i cili e ka orgjinë prej një lagje punëtore qyteti Kasimapa, shumë herë ka komentuar se Stambolli është çelësi i kontrollit ndaj Turqisë.

Publicitet

NGA MAGJIA E ZEZË DERI NË PROSTITUCION TË DETYRUAR

Secila viktimë duhet t'i nënshtrohet Jujusë. Rituali ka për qëllim të garantojë që gratë t'i paguajnë borxhet e tyre dhe të mos ikin apo të shkojnë në polici. Shumë prej tyre besojnë në këtë ritual, ama janë të pakta ato që në fakt e dinë se çfarë do t'i pretë kur të mbërrijnë në Evropë

Një grua e panjohur ia preu Joyit lëkurën me një brisk rroje në dhjetëra vende, së pari mbi gjoks e pastaj edhe afër organit gjenital. Më pas ia hodhi një pluhur të zi mbi plagët. Mund të ketë qenë qymyr druri apo diçka tjetër. Joy nuk e di saktë. Asaj as nuk i pëlqen të flasë për ato që i ndodhën në dhjetorin e 2014-s, kur ishte ende vetëm 17-vjeçare. Ama rituali i errët është pjesë e një praktike fetare - "Juju" - në atdheun e saj afrikanoverior. Gruaja që e performoi ritualin ishte "padronia" e saj, siç njihen ndryshe gratë që i trafikojnë vajzat e reja nigeriane. Ato rekrutojnë sa më shumë vajza përpara se t'i trafikojnë në Evropë dhe t'i detyrojnë në prostitucion. Faktikisht, secila viktimë duhet t'i nënshtrohet Jujusë. Rituali ka për qëllim të garantojë që gratë t'i paguajnë borxhet e tyre dhe të mos ikin apo të shkojnë në polici. Shumë prej tyre besojnë në këtë ritual, ama janë të pakta ato që në fakt e dinë se çfarë do t'i pretë kur të mbërrijnë në Evropë.

NË DUART E "PADRONES"

"Padronia ishte e mallëngjyer, njësoj si dhe unë. Isha disi e lehtësuar, ama nuk e dija se po më priste ferri. Më pyeti nëse dija të përdorja kondom.... Ishte shqetësuese dhe i thashë se nuk doja të dëgjoja pyetje të çmendura, si të bie në shtrat me një burrë, si ta kënaq..... Ajo më dërgoi në lagjen me drita të kuqe në Mannheim në shëtitje. E kur mbërritëm te një derë e pyeta se çfarë po bënim këtu. A është kjo shkollë, ngase nuk dukej si e tillë. Por ajo më tha se ky ishte vendi ku do të punoja për të", tregon Joy, emri i së cilës është ndryshuar për shkaqe sigurie. Ajo që pasoi, Joy tha të ishte një zemërim shumë i madh dhe lutjet për të mos e çuar aty ku e kishte bërë veç më nijet. "Në fillim mendova se po tallej, sepse kjo nuk ishte ajo që më kishte thënë më herët.

E ajo qeshi dhe më pyeti: 'Po çfarë po mendoje? Se do të të sjell këtu për të studiuar? Me cilat para do të duhej ta paguaja shkollimin tënd?", tregon ajo, duke folur për "Der Spiegelin". Joy i lutej pa ndalim që ta kthente në Afrikë, për t'i vazhduar studimet në paqe. Por përgjigjja që mori ishte se tanimë ishte bërë shumë vonë. Për të mbërritur në Gjermani, gjithçka rreth saj duhej të ishte e rreme. Pasaporta, emri në të.... Dhe për krejt këto, Joyit i ishte hapur llogaria e borxhit. "Ishte si në ferr, si një ferr i njëmendtë. Dhe pastaj më duhej të punoja pa pushim. Krejt për të", tha ajo. Joy nuk qe në gjendje të shpëtonte nga ky ferr për dy vjet radhazi. Ajo u shtrëngua t'ia siguronte së paku 1.100 euro në javë "padrones" së saj. Megjithëkëtë, gjithçka ishte më e përballueshme sesa dajaku. Ato pak para që i mbeteshin në xhep ajo i shpenzonte për ushqim dhe grim, të cilin e kishte të domosdoshëm për punën e saj si prostitutë.

Në total, Joy thotë të ketë fituar rreth 50 deri në 60 mijë euro, shumë kjo për të cilën hetimet e policisë në Frankfurt tregojnë se përkojnë me dëshmitë. Joy për të parën herë e shiti trupin e saj në Mannheim, pastaj në Mainz. E gjatë gjithë kohës mendonte për Jujun dhe për efektin që do të kishte te ajo mosmbajtja e premtimit: sëmundjet, vuajtjet apo akoma më keq. Mbi të gjitha vuajtjet ishin kërcënimet që po i bëheshin familjes së saj në Nigeri. Kjo torturë nuk mori fund deri kur një grua iu afrua Joyit dhe e pyeti nëse besonte në Zot. Në atë moment, Joy u ndje e shpëtuar. U vendos në një qendër të përkujdesjes të organizatës "Të drejtat e grave janë të drejta të njeriut" (FIM), e cila u ofronte ndihmë grave emigrante në Frankfurt dhe bashkëpunonte ngushtë me hetuesit lokalë. Trafikimi i grave nigeriane nuk është një fenomen i ri për policinë e Frankfurtit, por problemi është intensifikuar me fluturimin e numrit të grave refugjate në vend. Më 2016, Organizata Ndërkombëtare e Migrimit (IOM) numëroi rreth 11.000 gra nigeriane që kanë kaluar Mesdheun në drejtim të Italisë. Kjo shifër është dyfish më e madhe sesa një vit më parë dhe pothuajse tetë fish më e lartë se më 2014.

Disa mbesin në Itali, teksa të tjerat e vazhdojnë rrugëtimin drejt vendeve të tjera evropiane. Disa prej atyre që mbërrijnë në Gjermani përfundojnë duke punuar në stacionin qendror të trenave në Frankfurt. Në këtë zonë, Daniel Kreuz (emri i ndryshuar) dhe ekipi i tij i hetuesve të Departamentit të policisë kriminale përqendrohen në prostitucion dhe trafikim të qenieve njerëzore. Në radarin e hetimeve të tij është rruga Taunus e Frankfurtit, e mbushur ngado me lokale që ofrojnë shërbime të prostitucionit. Bordelet e lagjes ofrojnë dhoma për një çmim prej 120 eurosh në ditë, plus taksën. "Kjo është një shumë tepër e lartë, kur kihet parasysh se prostitutat nga krejt kjo punë marrin vetëm nga 20 apo 30 euro", thotë ai. "Për sa u përket grave nga Nigeria, ato e kanë edhe një tjetër aspekt, atë kulturor dhe magjinë e zezë, që nuk hasen në rastet nga vendet e tjera. Ato fillimisht vijojnë një kurs magjie në një tempull magjie në Nigeri, përpara se të trafikohen. Aty ato betohen. Dhe me këtë rast, murgu që praktikon magjinë u merr disa gjëra personale. Një fotografi, rroba të brendshme, thonj, qime trupore, në disa raste publike. Frika e këtij rituali i lidh gratë me padronet dhe i ndalon që të bashkëpunojnë me policinë apo të shkojnë në polici për të kërkuar ndihmë", thotë Kreuz.

> Vajzat e lagjeve të varfra mund akoma të bien fare lehtë pre e padroneve. Dhe për aq kohë sa kërkesa për seks të lirë të jetë e lartë në Evropë, trafikimi i vajzave të reja do të vazhdojë të jetë biznes fitimprurës për trafikantët

Zyra e OKB-së për narkotikë dhe krime ka llogaritur se më shumë se 90 për qind e grave të trafikuara nga Nigeria në Evropë vijnë prej shtetit Edo dhe shumica e tyre janë nga qyteti i Beninit. Por pse bash prej aty? Dhe sa thellë e rrënjosur është Jujuja në mendjet e njerëzve të rajonit?

NË VENDIN E MURGJVE TË JUJUSË

Sunduesi tradicional i rajonit është mbreti i Beninit, "Oba". Si një i krishterë i devotshëm, ai është po ashtu lider shpirtëror i murgjve të Jujusë. Edhe sot e kësaj dite, ai akoma adhurohet nga masa të gjera të popullatës si një figurë Zoti dhe ani pse nuk ka më ndonjë autoritet zyrtar, fjalët e tij konsiderohen ligj për shumëkënd. Meqë bota përherë e më shumë po e ndërlidhte qytetin e Beninit me trafikim dhe shkalla e turpit po bëhej e papërballueshme, lideri shpirtëror vendosi se kishte ardhur koha për veprim. David Adebiri, një burrë me ndikim në vend, ka qenë për vite të tëra këshilltar i Obas. Si më i besuari i tij, ai flet në emër të mbretit.

"Nuk mund as të shpjegoj pse Benin City është bërë kryeqendër për trafikim ilegal të qenieve njerëzore. Jemi ngritur kundër kësaj. Presidenti (mbreti) Oba ka ndërmarrë të gjithë hapat e domosdoshëm, ligjërisht dhe tradicionalisht, për t'i mallkuar të përfshirët në këtë praktikë ilegale. Efekti ishte i menjëhershëm. Ai shkoi edhe më tutje, për t'u dhënë imunitet automatik të gjithë atyre vajzave dhe djemve që kanë mundur të bien viktima", tha ai. Në lagjen "Sakpoba", ku ishte rritur Joyi, murgu "Eziza", Sylvester Enoma, praktikon rituale Juju për çdo ditë. "Kur njerëzit vijnë këtu dhe thonë se janë të sëmurë, ata kërkojnë ndihmë prej perëndeshës së erës Eziza. Varësisht prej asaj se çfarë ajo u thotë, ata sjellin nga një dhi apo kurban tjetër për sakrificë", tha Enoma.

"Krejt çfarë ne bëjmë është të shërojmë njerëz". Magjia Juju është e kudogjendur në Benin City. Aty shumica e banorëve janë ose të krishterë ose myslimanë, por zbati-

min e praktikave shpirtërore nuk e konsiderojnë kundërthënëse. Në të vërtetë, njerëzit e respektojnë - dhe i druajnë - më shumë religjionit sesa pushtetit të shtetit. Betimet që bëhen para zotëve, shpirtrave apo paraardhësve në ritualet Juju merren seriozisht. Por vetëm ky konsolidim i rendit fetar nuk është i mjaftueshëm për të shpjeguar pse Benin City e ka problemin me trafikim dhe prostitucion. Aty tani ekzistojnë organizata humanitare, si "Të bijat e bamirësisë", që ndihmojnë gratë e traumatizuara dhe të dëshpëruara, pas kthimit nga Evropa. Shumica e vajzave e zgjedhin ikjen nga vendi pas presionit nga familjet, thotë Bibiana Emenaha, drejtoreshë e organizatës. Që prej 2003-s, Agjencia Kombëtare e Ndalimit të Trafikimit (Naptip) ka luftuar rrënjët e shkakut të problemit në Nigeri. E një prej tyre është mungesa e mundësive. Nigeria nuk është vetëm vendi më i populluar i Afrikës, por është edhe ekonomia më e madhe nënsahariane. Është e pasur me naftë dhe gaz teksa sektorët bujqësor dhe të shërbimeve janë në lulëzim. Më shumë se 62 për qind e nigerianëve megjithatë jetojnë në varfëri të skajshme.

Për shumicën e grave, prostitucioni është e vetmja mënyrë për të bërë para. "Ama nuk është krejt vetëm te varfëria. Shumica shkojnë në Evropë me mision tregtar, që të blejnë rroba, këpucë, xhingla dhe të kthehen për t'i shitur këtu. Dhe papritmas kuptojnë se ka kërkesë aty dhe fillojnë t'i rrisin fitimet duke punuar si prostituta. Dhe njerëzit me injorancë besojnë se nëse personi A ia ka dalë, atëherë edhe Bja mund të shkojë dhe të ketë sukses. Këtu është i përfshirë edhe elementi i lakmisë....", thotë Nduka Nwanwenne i Naptipit.

NË ËNDRRAT E TYRE

Ato gra që mbërrijnë në Evropë dhe kthehen në Nigeri me para, ndërtojnë shtëpi, blejnë vetura dhe gjejnë mënyra për ta rritur pasurinë e tyre. Shpesh "padronet" e shfrytëzojnë këtë gjë për t'i joshur vajzat e reja në prostitucion. Jennifer dhe Vivian dikur e ndanin këtë ëndërr. Në të shkuarën, ato kishin fluturuar në Evropë me dokumente të rreme, por kjo qe shumë e kushtueshme për "padronet". Sipas policisë në Frankfurt, kostoja e udhëtimit me aeroplan, përfshirë nxjerrjen e dokumenteve false dhe mbulimit të shpenzimeve shtesë për trafikim, kap shifrën prej 10 mijë eurosh për person. Por shtigjet e reja - përgjatë shkretëtirës së Libisë dhe përreth Mesdheut - kushtojnë rreth 1.500 deri 2.500 euro. Ani pse më lirë, ky shteg është më i rrezikshëm për gratë që trafikohen, pasi që i rrezikojnë jetët. "Më 2017, udhëtova nëpërmjet Libisë për t'u kthyer sërish në Evropë.

Nuk kisha ushqim, ujë, isha në shkretëtirë. Kaluam pothuajse tre muaj në shkretëtirë para se të mbërrinim në Libi. Vetëm Zoti na shpëtoi", tregon Jennifer, emri i së cilës po ashtu është ndryshuar. "Shumë njerëz po vriteshin në Libi. Neve na trajtonin shumë keq. Po i përdhunonin vajzat. Ishte tmerr", tha Vivian. Shumë gra, si puna e tyre që tanimë janë kthyer në Nigeri, kanë humbur besimin në Qeverinë. Ankohen për korrupsionin dhe kërkojnë mbështetje më të madhe. Dhe pikërisht në mungesë të tyre ato zgjedhin të rrahin rrugën drejt Evropës. Jennifer dhe Vivian thonë se do të shkojnë sërish - vetëm se herën tjetër me aeroplan. Shefi i Naptipit dhe këshilltari Edebiri pajtohen se ndalesa e zbatuar nga Oba do ta ulë dukshëm shkallën e trafikimit në Nigeri. Madje mund edhe ta eliminojë. Por jo të gjithë janë kaq optimistë. Edhe nëse banorët e qytetit vetëdijesohen më shumë për rreziqet e trafikimit, problemi thjesht do të zëvendësohet në fshatra, thotë Bibiana.

Vajzat e lagjeve të varfra mund akoma të bien fare lehtë pre e padroneve. Dhe për aq kohë sa kërkesa për seks të lirë të jetë e lartë në Evropë, trafikimi i vajzave të reja do të vazhdojë të jetë biznes fitimprurës për trafikantët. Në Gjermani, hetuesit dyshojnë se pas ndalesës së Obas, akoma më shumë viktima do të hezitojnë të bashkëpunojnë me policinë. Për gratë si Joy, pushteti i mbretit të Beninit është barasvlershëm me shpëtim. "Dua t'u them të gjithëve që të mos bien në këtë kurth. Nuk është se këtu në Gjermani mund të mblidhni para në tokë. Nuk është bankë këtu. Është shumë më ndryshe sesa njerëzit mendojnë", thotë Joy.

"Gardianët" specialë të Kremlinit

Detyra e grabitqarit është të mbrojë Kremlinin, një nga fortesat më të vjetra mesjetare në Europë, që ka shërbyer si seli e carëve, udhëheqësve të ish-BRSS, e tashmë presidentëve rusë

Quhet "Alpha" dhe ngrihet mbi kubenë e artë të Kremlinit, duke mbjellë panik mes sorrave që tentojnë të ulen në pemët përreth. Skifteri me krahë të shkurtër është vetëm njëri prej një dyzine zogjsh grabitqarë që "mbrojnë" selinë e pushtetit të presidentit Vladimir Putin në Moskë.

Turma të shumta fluturakësh mblidhen në kopshtin "Tainitsky" brenda mureve me tulla të kuqe të Kremlinit, tentojnë të kërcejnë nga pema në pemë dhe fluturojnë në hapësirën ajrore të Kremlinit. Por, mjafton të lëshohet në "mision" grabitqari femër, 20-vjeçar, "Alpha", sikurse edhe "kolegu" i saj "Filya", që i përafrohet një shqiponje, dhe "të huajt e paftuar" largohen brenda pak sekondash nga selia e pushtetit rus. "Synimi ynë nuk është që t'i heqim qafe shpendët e tjerë, por vetëm t'i trembim e t'i largojmë, në mënyrë që ata të mos arrijnë të krijojnë strehë këtu, të mos ndërtojnë fole", thotë për AFP-në 28-vjeçari Alexei Vlasov, një prej trajnuesve skifterësh, me veshje speciale, nga shërbimi ornitologjik i Kremlinit.

Njësia speciale e ngritur në vitin 1984 ka rreth një dyzinë zogjsh, përfshi këtu skifterë dhe një fajkua "peregrine". Ajo është pjesë e Shërbimit Federal të Gardës. Detyra e grabitqarit është të mbrojë Kremlinin, një nga fortesat më të vjetra mesjetare në Europë, që ka shërbyer si seli e carëve, udhëheqësve të ish-Bashkimit Sovjetik, e tashmë presidentëve rusë, e që është pjesë e Trashëgimisë Botërore të mbrojtur nga UNESCO.

Shpendët fluturues "mund të transmetojnë një numër të caktuar sëmundjes që janë potencialisht të rrezikshme për shëndetin e njerëzve", sikurse "mund të dëmtojnë kubetë e arta duke i çukitur e duke shkaktuar vrima në to", thotë Vlasov, teksa mban në duart e tij "Alphën". Personi që kujdeset për këtë njesi speciale thotë se ato mund të bëhen edhe "shqetësuese apo agresive" në bashkëveprim me njerëzit.

KOMIKJA DHE 'BORDELIZIMI' I EROTIKËS RURALE

'Seizmologjia' e ndryshimeve së pari vërehet në xhami, por edhe në çajtoren e fshatit, ndërkohë që 'bordelizimi' që kishte prekur disa nga fshatarët kishte ndikuar që ritmi i jetës të ndryshojë, si në jetën private-familjare, ashtu edhe në jetën publike, madje edhe në shkollë, ky me pak fjalë është syzheu i këtij filmi

Koha Nga Emin AZEMI

'Pranverë e paharruar në fshatin e harruar', është filmi më i ri, por edhe i parë i metrazhit të gjatë, i regjisorit tash më të afirmuar dhe mirëpritur në mbarën hapësirën kulturore shqiptare, Kushtrim Bekteshi, i cili është edhe autor i skenarit. Vendosja e unitetit artistik midis skenarit dhe regjisë së të njëjtit autor, bëri që premiera e këtij filmi të premten në Shkup të përjetohet si një festë artistike dhe ata që e panë patën arsye të largohen të kënaqur nga salla kinemasë Cineplexx .

Një plan i gjerë, me atmosferë mëngjesi në fshat i paraprinë rrëfimit filmik. Njerëzit teksa zgjohen nga gjumi, kurse hoxha i fshatit (në interpretim brilant të Osman Ahmetit) në rrugën gjarpërore me kaldrëm i drejtohet xhamisë për të thirrur ezanin e mëngjesit, ndeshet në një skenë që e bën hoxhën të ndalë hapin, por edhe të merr një pamje të vëngërt në fytyrë. Në një gjendje krejt të shkujdesur, qentë po bënin seks, kurse hoxha pa një pa dy i merr në shenjë me gurë. Qentë largohen duke hingëlluar nga dhimbja e goditjes. Kjo skenë-uverturë sikur na e imponin në formë sygjestive lajtmotivin dhe atmosferën e mëtutjeshme që do të pasojë në film. Seksi si biznes dhe aventurat erotike në prapavijë, komikja në shkallë grotesku si pëlhurë që mundohet të mbulojë vrazhdësinë e realitetit dhe mllefi i grave bashkë me hoxhën për atë që po iu ndodhte para hundëve me burrat e tyre, është trajektorja fabulative që e përshkon gjithë kompozicionin e filmit.

DEKANONIZIMI I JETËS SË QETË TË FSHATIT

Një ditë të bukur me diell, të gjithë, gra e fëmijë, pleq e të rinj, e kishin vërejtur se nëpër lagjet dhe shtëpitë e patrazuara të tyre ishte futur një 'demon' që po ua gërryente rehatinë.

Një shtëpi e zakonshme fshati brenda natës shndërrohet në kafene-bordel, ku përveç tjerash, myshterinjve nuk iu jepet vetëm kafe e raki. Aty vinë edhe tri femra, të cilat shesin trupin e tyre, kurse si makro i tyre paraqitet Xhinga (Shkumbin Istrefi), një dallaveraxhi i imët i katundit që kishte vendosur të bëhej i pasur duke ua 'qethur' xhepat bashkëfshatarët e tij naiv.

Rrëfimin e tij Kushtrim Bekteshi e ka vendosur një 'topografi' rurale, me një vizualitet mjaft dinamik, i imponueshëm për nga kontrastet e forta në mes të njerëzve dhe ngjarjeve, në mes të konvencionit moral dhe aventurave tekanjoze të një grupi meshkujsh që kishin vendosur ta dekanonizonin jetën e qetë të fshatit. Veset e tranzicionit të stërzgjatur që nuk po mundnin assesi të sillnin në fshat ndonjë mirëqenie dhe mendësi të avancuar, saora bëhen normë sjelljeje për një pjesë të burrave, të cilët në thelb nuk janë karaktere komike, por sillen dhe veprojnë në rrethana e situata që shndërrohen në trajta komike.

Vetëm një burrë me pjekuri të vonuar në provincë (Dauti, i interpretuar mjeshtërisht nga Vebi Qerimi) mund të mburret publikisht me mashkullaritetin e të birit, pasi e ka detyruar me forcë të kryej marrëdhënie intime me njërën nga gratë e kafe-bordelit.

TEKNIKA E NDËRTIMIT TË INTRIGËS

Me tematikën që ka zgjedhur ta trajtojë në film, Kushtrim Bekteshi nuk mëton të inventarizojë për herë të parë ngjarje devijante që tash më ishin të pranishme në mjediset rurale. Sjellja e tri prostitutave në fshat nga ana e Xhingës, nuk paraqet lajm për shikuesin e filmit, sidomos tash pas disa viteve kur filmi është xhiruar, por ajo që e bën këtë fabulë filmike të veçantë është teknika e ndërtimit të intrigës, e cila kalon pahetueshëm nga njëri nivel psikologjik e shpirtëror, në tjetrin, nga një situatë dramatike në një situatë komike, gjithnjë duke e shtuar intensitetin e brendshëm shpirtëror të atyre që ishin të prekur nga këto ngjarje. Tundimet e njerëzve pas aventurave erotike dhe dimensioni komik i paraqitjes së skenave, janë disa nga fshehtësitë e kësaj teknike, me të cilën Kushtrim Bekteshi ka operuar mjeshtërisht.

'Seizmologjia' e ndryshimeve së pari vërehet në xhami, por edhe në çajtoren e fshatit, ndërkohë që 'bordelizimi' që kishte prekur disa nga fshatarët kishte ndikuar që ritmi i jetës të ndryshojë, si në jetën private-familjare, ashtu edhe në jetën publike, madje edhe në shkollë. Disa nxënës, duke e shfrytëzuar shpërqendrimin e prindërve të tyre dhe të disa mësuesve bashkë me drejtorin, kishin marrë guximin madje të korrigjojnë notat në ditarin shkollës. Ky skandal nuk kalon pa u vërejtur, por ata që duhej të ndëshkonin e ndjenin veten fajtor për situatën ku kishte degjeneruar shkolla e tyre. Në radhë të parë ishte drejtori ai që ishte i dyzuar si zyrtar dhe si klient femrash të lira, dhe halli i tij nuk ishte vetëm menaxhimi i shkollës, por edhe 'mbytja kohës së tepërt' në kafenenë që po ofronte më shumë se kafe e raki.

Xhamia, aty ku bëhet 'destilimi' moral kishte mbetur gati pa xhemat, shkolla pa rendin dhe disiplinën e dikurshme, kurse gratë pa burrat e tyre në shtrat. Kafeneja-bordel po konkurronte me ofertat e pazakonta, sepse aty nuk po shitej vetëm mishi i bardhë, por po 'farkohej' edhe një klientelë e re që po e prishte imazhin e një mjedisi deri dje të qetë e të moralshëm.

Të vetmit që përfitojnë në këtë rrëmujë janë Agimi dhe Albulena, dy të rinj prej prindërve të hasmuar, të cilët dashurinë e tyre të ndaluar e kurorëzojnë me fejesë, pas katarsisit që ndodhë në fund të rrëfimit filmik, atëherë kur edhe triumfon kodi moral i grave të cilat bashkë me djegien e kafenesë-bordel, arrijnë të shkulin nga jeta e tyre edhe shkaktaret që e kishin sjellë gjithë atë çrregullim në jetën e tyre.

KOMIKJA SI ALEATE E ANTITRAUMËS

Vizualitei dinamik i filmit na bën të mos hetojmë kapërcimet nga njëra sekuencë në tjetrën dhe kjo e bënë cilësinë e receptivitetit shumëfish të efektshme për vetë komunikimin me ngjarjet dhe njerëzit. Kjo, mbase, ka bërë që filmi të ketë një strukturë të ngjeshur të fotografisë, ku qartësisht vërehet marrëdhënia aktive në mes të ngjyrave, njerëzve, objekteve, linjave dalluese ditë-natë dhe kontrasti i tonalitetit hapësinor, me konotacion komik, që regjisori Bekteshi me gjeturi i ka vendosur disa mikrongjarje, siç është, bie fjala, skena me burrat para kafenesë, që për një moment ndriçohen nga dritat e automobilave teksa po kryenin nevojën pas 'recetave' hileqare të grave të përgatitura enkas për të nxitur jashtëqitjen, një prej mjeteve 'luftarake' që përdornin ato për të larguar burrat e tyre nga kafeneja-bordel.

Pastaj është edhe një skenë tjetër, e vendosur në oborr të shkollës, ku një pjesë e publikut ende pa pritur të përfundojë fjalimi i drejtorit (Ndriçim Xhepa) dhe prefektit (Luan Jaha), vrapon drejt tryezës së koktejit.

Momente të tilla, ku në prapavijë tonaliteti komik iu jep skenave një gradacion dramatik me emocione të përziera, siç mund të jenë edhe sekuencat e fundit teksa gratë e fshatit po e 'pushtonin' kafenenë-bordel dhe po nxirrnin prej andej 'bombat' në formë grash të përdala që ua kishin turbulluar mendjen burrave të tyre. Gjithë kjo rrëmujë përcillej edhe me momente komike dhe ky, mbase, do të duhej të ketë qenë një prej objektivave artistike të skenarist dhe regjisorit Kushtrim Bekteshi, që përmes dimensionit komik të fabulës të bëjë amortizimin socio-psikologjik të tematikës dhe dromcimin e specifikave të mentalitetit në 'pllakëza' të imta që lehtësisht mund të vendosen edhe në ndonjë mjedis tjetër, me një prejardhje krejt tjetër etno-kulturore. Elementi komik është një aleat i mirë i antitraumës dhe, për rrjedhojë, në situata më konfliktuoze të imponohet nevoja për të qeshur , që ishte edhe prezent gati gjatë gjithë shfaqjes së filmit. Atëherë kur punët shkonin keq, vinte një moment komik që e bënte situatën të ventilohej nga tendosja psikologjike e protagonistëve, sidomos të grave, të cilat kishin zgjedhur hoxhën si aleat për t'iu ndihmuar në rikthimin e burrave, pasi që këtyre të fundit iu kishte ikur truri pas atyre grave të përdala.

Aventurat erotike në një ambient rural përfundojnë pasi bëhen bashkë përpjekjet e grave të fshatit dhe hoxhës për të shporrur 'virusat' e ndotjes morale e fizike, kurse gradacioni kompozicional i fabulës filmike ndërtohet mbi një parabolë tematike që nxjerr të fituar, megjithatë, idenë e ruajtjes së pastërtisë morale nga prirjet dehumanizuese të një shoqërie të konsumit, seksit e drogës.

KASTA E AKTORËVE

Kasta e aktorëve të angazhuar në këtë projekt të kinematografik ka për bazë përzgjedhjen që korrespondon me karakteret e personazheve, kurse heterogjeniteti hapësinor prejardhjes së i aktorëve e bënë këtë projekt edhe më domethënës në pikëpamje të seriozitetit artistik e menaxhues të vetë regjisorit, por edhe të producentëve (Osman Ahmeti, Mumin Jashari, Sasho Pavlovski) si dhe institucioneve që kanë mbështetur filmin 'Pranverë e paharruar në fshatin e harruar'. Profili i secilit prej aktorëve (Osman Ahmeti, Luan Jaha, Muzbajdin Qamili, Adem Karaga,Vjollca Bekteshi, Salaetin Bilall, Ilire Vinca, Vebi Qerimi, Teuta Jegeni, Musa Isufi, Drita Karaga, Adriana Matoshi etj.) imponoi kureshtjen e publikut, kurse formësimi plastik i karakterave që ata zhvilluan gjatë aktrimit jep të kuptojmë se kinematografia shqiptare tash më i ka yjet e veta dhe si të tillë ata mund të ndriçojnë pa kurrfarë kompleksi në çdo festival të botës.

Ky projekt kinematografik, përpos vlerave artistike që u shquan në skenar, regji dhe aktrim, do të mbahet mend edhe për nxitjen që ua ka dhënë disa fëmijëve dhe të rinjve, të cilët me talentin dhe përkushtimin e dëshmuar mund të jenë nesër aktorë të formatit të madh, sikundër u dalluan Etnik Ratkoceri në rolin Hekuranit, Muhamed Qamili në rolin e Ermirit dhe Lis Jashari në rolin e Liridonit.

"Qëllimi im është kualifikimi në Kampionatin Evropian. Nuk duhet të krijohet presion ndaj futbollistëve, që një gjë e tillë me çdo kusht duhet të arrihet, mirëpo nëse na jepet rasti, duhet ta shfrytëzojmë", ka deklaruar Milevski

BLAGOJA MILEVSKI PREZANTOHET TE MAQEDONIA U21

QËLLIMI JONË ËSHTË KUALIFIKIMI NË KE

Koha — Fisnik NUHIU

Shkup, 3 prill - Reprezentacioni i Maqedonisë U21 edhe zyrtarisht ka prezantuar si selekcionuesi të ri të Maqedonisë së Veriut, Blagoja Milevskit. Trajneri shkupjan rikthehet sërish për t'i udhëhequr shpresat, duke firmosur kontratë 2 vjeçare. Seleksionuesi Milevski më herët ishte pjesë Maqedonisë U21, me të cilët u fut në histori duke u kualifikuar në Kampionatin Evropian të Polonisë. Milevski është optimist se edhe me gjeneratën e re që në na dispozicion mund të arrijë që të luaj në një Evropian. "Është nder dhe kënaqësi që FFM shprehi dëshirë që të bashkëpunojmë përsëri. Shpresoj të kemi një bashkëpunim të mirë edhe në të ardhmën. Kemi një grup shumë të fortë ku Spanja shifet si favorit, por ne duhet që të tregojmë kualitetet tona me çdo kundërshtarë. Në Antali kemi kampin selektues zhvilluam tri ndeshje dhe të gjithë patën rastin të luajnë. Jam i kënaqur me atë çka pash dhe si luajtëm", theksoi Milevski. I cili më pas ka shtuar se qëllimi i tij kryesor është kualifikimi në Kampionatin Evropian. "Qëllimi im është kualifikimi në Kampionatin Evropian. Nuk duhet të krijohet presion ndaj futbollistëve, që një gjë e tillë me çdo kusht duhet të arrihet, mirëpo nëse na jepet rasti, duhet ta shfrytëzojmë. Ne nuk jemi Spanja, Brazili apo Gjermania. Duhet të bëjmë më të mirën nëse na jepet rasti. Pavarësisht rezultateve jot ë mira në disa nga eliminatoret e fundit, besoj se do të luajmë shumë më mirë dhe se do të arrijmë rezultate shumë të mira", tha Milevski.

Shqipëria dhe Kosova në kahe të kundërta, lëvizjet në renditjen e FIFA-s

Shqipëria u mposht nga Turqia dhe mposhti Andorrën në muajin mars, por kjo nuk do t;u shërbejë kuqezinjve për të ngjitur ndonjë shkallë në renditjen e FIFA-s, që pritet të publikohet më 4 prill. Kombëtarja jonë pritet të zbresë një pozicion. Aktualisht Shqipëria renditet në vendin e 61-të, ndërkohë që tashmë do të pozicionohet e 62-ta. Ndryshe nga ne, Kosova do të ngjitë dy shkallë. Dardanët do të vijojnë ngjitjen, teksa lënë vendin e 130-të dhe tashmë do të jenë të 128-t në renditjen e FIFA. Skuadra e drejtuar nga Bernard Shaland luajti në mars dy ndeshje. Ata barazuan në Prishtinë me Danimarkën në një ndeshje miqësore, ndërkohë që më pas në takimin me Bullgarinë morën një pikë. 1-1 u mbyll ajo përballje, e vlefshme për kualifikueset e EURO 2020.

"Dardanët" bindin talentin shqiptar ta zgjedhë Kosovën

Kosova U21, ka arritur ta bindë mbrojtësin shqiptar, Valon Hamdiu, ta vesh fanellën e Dardanëve. Hamdiu që luan te Winterthur U21, është nga Maqedonia Veriore, dhe do të jetë i gatshëm për përzgjedhësin Rafet Prekazi qw nga grumbullimi i ardhshëm. Burimet e Sportit, pranë Federatës së Futbollit të Kosovës, kanë bërë të ditur se lojtari ka pranuar ta veshë fanellën e Kosovës, dhe kanë nisur proceduratë për t'u pajisur me pasaportën kosovare. Së fundi edhe përzgjedhësi i Kombëtares së Shqipërisë U21, Alban Bushi, e kishte monitoruar nga afër lojtarin për ta ftuar me "kuqezinjtë".

LIGA E DYTË: LINDJE-PERËNDIM

Struga TL shkatërron Vëllazërimin

Shkup, 3 prill - Të martën janë zhvilluar ndeshjet e javës së 19 në Ligën e Dytë të Maqedonisë së Veriut, Lindje-Perëndim. Ekipi i Struga Trim Lum ka shënuar fitore të thellë 5:0 ndaj Vëllazërimit të Kërçovës. Rezultatin e hapi Hristijan Dragarsi, ndërsa shifrta në dy me zero i rriti lojtari kundërshtar Ilir Memeti i cili shënoi autogol. Në listën e golashënuesve u regjistruan edhe Flamur Tairi, Altin Loga dhe Florent Osmani. Më këtë fitore skuadra e Struga Trim Lum ruan pozitën e parë me 37 pikë, ku ka 6 pikë më shumë se ndjekësi Labunishti të cilët në takimin e javës së 19 me shumë mund arritën të mposhtin Korabin me rezultatin 1:0, me golin e vetëm të shënuar nga Pajazit Saliu në minutën e 88 të takimit. Teteksi ka arritur të befason Pelisterin në Manastir duke e mposhtur me rezultatin 1:0. Gostivari me golin e Jasir Selmait shënoi fitore ndaj Genç Kalemler. Në takimet e zhvilluara në Ligën e Dytë - Perëndim, lideri i tabelës Boreci i është rikthyer fitoreve duke shënuar fitore të thellë 7:1 ndaj Detonit. Rezultat të thellë ka arritur edhe Kit Go të cilët fituan 4:0 ndaj Sasa Kamenica. Tikveshi mori fitore minimale 1:0 ndaj Plaçkovicës, ndërsa Kozhufi ishte më e mirë se Partizan Obrshani duke fituar me

FUTSAL

Kushtet dhe sponsorët nuk e penguan Shkupin të shpallet kampion

Shkup, 3 prill - Futsall Shkupi në fundjavën që lamë pas siguroi titullin e kampionit për sezonin 2018/19 në futbollin elitar që luhet në palestër. Fitorja 4:3 në parketin e rivalit direkt për kreu Velesin, solli titullin e dytë në histori për futsall Shkupin katër xhiro para mbyllje së kampionatit. "Gjëja më e bukur kur shpallesh kampion është kur e bën atë në vendin e rivalëve kryesor", tha Arsim Fazliu, kapiten i Futsal Shkupit në emisionin Sportmania. Mirëpo edhe pse janë më të mirët dhe dominojnë futbollin në palestër, financat dhe sponsorët vazhdojnë të jenë problemi kryesor te Shkupi. "Lëre rrogat, por nuk i ke as kushtet elementare. Paguajmë palestër që i zhvillon ndeshjet, ndërsa edhe atë palestër që e kemi në stërvitje nuk e kemi në orarin që duhet ta kemi, pasi një skuadre kampione i duhet më së paku një orë e gjys ose dy stërvitje", shprehet Besnik Shabani, zëdhënës i Futsal Shkupit "Kemi rroga minimale që janë, por na duhen më shumë. Na nevojiten sponsor, na duhen financa, na nevojiten kushte për të cilat kemi nevojë shumë", tha kapiteni i bardhekaltërëve. Futsal Shkupi, titullin e kampionit do ta pranojë në fillim të muajit maj në ndeshjen e fundit të kampionatit ndaj Zhelezarecit. Ndërkohë "bardhekaltërit" nesër do të luajn në çerekfinale të Kupës së Maqedonisë kundër Cikos, me ndeshjen që do të zhvillohet në palestrën "Enver Idrizi" nga ora 21:00.

Sipas nenit 84 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.124/15) Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, pavarësisht përpjekjeve për të kryer shpërndarjen e akteve administrative të miratuara në procedurë administrative bën shpallje publike përmes:

N J O F T I M

Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ka sjell akte administrative të cilat nuk mund t`i parashtrojë personalisht edhe atë:

1. Vendimi nr. 2016-68-0001260/2 i datës 13.11.2018 për Avdili Nura, Vaksince 1306, komuna Likovë, Kumanovë.
2. Vendimi nr. 2016-78-0006522/2 i datës 13.11.2018 për Tashev Tasho, rr.Gjorgji Trajkov nr.6, Strumicë.
3. Vendimi nr. 2016-78-0000305/2 i datës 13.11.2018 për Neceva-Janeva Irinka, f.Velusa 2414, Strumicë.
4. Vendimi nr. 2016-78-0006478/2 i datës 13.11.2018 për Projkov Petar, rr.Geras Cunev 7, Strumicë.
5. Vendimi nr. 2016-67-0000252/2 i datës 13.11.2018 për Jakimoviq Desa, Vladimir Komarov nr.12, Aerodrom, Shkup.
6. Vendimi nr. 2016-78-0004231/2 i datës 13.11.2018 për Angelov Gjorgji, f.Banicë, Strumicë.
7. Vendimi nr. 2016-78-0002223/2 i datës 13.11.2018 për Jangelovski Mladen, rr.Braqa Milladinovi nr.39/1-8, 2400 Strumicë.
8. Vendimi nr. 2016-78-0000857/2 i datës 13.11.2018 për Vitanov Branko, rr.Edinstvo nr.5, Kavadar.
9. Vendimi nr. 2016-78-0005858/2 i datës 13.11.2018 për Vitanov Tusho, f.Veljusë 2414, Strumicë.
10. Njoftimi nr. 12-5/263 i datës 13.02.2019 për Lita Shpknjp Ohër, f.Velgoshti, 6330 Strugë.
11. Vendimi nr. 12-1250/4/10 i datës 15.02.2019 për DPTU Biljana Promet, rr.6 nr.10 Ilinden, Shkup.
12. Vendimi nr. 12-1250/11/5 i datës 20.02.2019 për Margo Shpknjp, rr.Partizanska nr.84-3, Shkup.
13. Vendimi nr. 12-1250/4/15 i datës 15.02.2019 për PAM-EKS SHPKNJP, rr.Blagoj Gjorev pn, Veles.
14. Vendimi nr. 12-1250/11/19 i datës 20.02.2019 për DPTU Biljana Promet SHPK, rr.6 nr.10 Ilinden, Shkup.
15. Vendimi nr. 12-1250/11/6 i datës 20.02.2019 për fermën e shpezëve "Gjashtë vëllezërit" rr.1 nr.133 komuna Studeniçan, Shkup.
16. Vendimi nr. 12-125/4/12 i datës 15.02.2019 për fermën e shpezëve "Gjashtë vëllezërit", rr.Pero Nakov pn - Shkup.
17. Apeli nr. 12-1-24/2 i datës 07.02.2019 për Aleksandar Mazni, rr.Nju Delhiska nr.9, Shkup.
18. Njoftimi nr. 2018-55-0051922/3 i datës 05.02.2019 për Ranç N Dooel, rr.4 nr.66, f.Rzhaniçinë, komuna Petrovec, Shkup.
19. Njoftimi nr. 2018-79-0001508/3 i datës 08.02.2019 për Shabanoski Shaban, Belicë e poshtme 6334, Strugë.
20. Njoftimi nr. 2018-51-0098338/3 i datës 17.01.2019 për Muaremovski Tela, rr.A pn, Ostrec, Manastir.
21. Njoftimi nr. 2018-75-0002009/2 i datës 24.10.2018 për Agro Delta, f.Vrashticë e poshtme, komuna Konçe, Radovish.
22. Vendimi nr. 12-5/49 i datës 10.01.2019 për DPP "Cek-Komerc" SHPK Import-Eksport, rr.Sheshi Ilinden nr.20-4, Sveti Nikolle.
23. Vendimi nr. 12-5/50 i datës 10.01.2019 për UNI AGRO SHPK, rr. Zhivko Firov nr.63, Veles.
24. Njoftimi nr. 16-766/5 i datës 25.03.2019 për DOMAIN BAROVO SHPKNJP, rr. Vlladimir Polezhinovski nr.14, Qendër Shkup.

Ftohen personat e lartpërmendur në afat prej 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të njoftimit të lajmërohen në hapësirat e Agjencisë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural - Shkup për ngritjen e vendimeve, në qoftë se nuk lajmërohen, ky njoftim me shpallje publike do të konsiderohet si dorëzim i rregullt në pëlqim me nenin 84 paragrafi 6 nga Ligji për procedurën e përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 124/15).

Në bazë të nenit 24 të Ligjit për planifikimin hapësinorë dhe urbanistik ("Gazeta zyrtare e RM" nr.51/05, 137/07, 91/09, 124/10, 18/11, 53/11, 144/12, 55 /13, 163/13, 42/14), nenit 50 pika 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gaz. zyrtare e RM-së" nr. 5/02) dhe Programit vjetor për punimin e planeve urbanistike në territorin e Komunës së Jegunovcit dhe planeve urbanistike jashtë vendbanimeve për vitin 2019, me Vendim nr. 08-78/6 të datës 25.01.2019 të Këshillit të Komunës së Jegunovcit, Kryetari i Komunës së Jegunovcit e lëshon këtë:

L A J M Ë R I M

për organizimin e prezantimit publik dhe anketës publike për Projekt planin **"Plani Urbanistik për fshatin Kopanicë KK Kopanicë, Komuna e Jegunovcit për periudhën planore 2014 –2024, me sipërfaqe të përfshirjes prej 57,25 ha"**

Kufijtë e përfshirjes janë të treguar në shtojcën grafike e vendosur në vend të dukshëm në hapësirat e Komunës së Jegunovcit.

Anketa publike dhe prezantimi publik për Projekt planin **"Plani Urbanistik për fshatin Kopanicë KK Kopanicë, Komuna e Jegunovcit për periudhën planore 2014–2024, me sipërfaqe të përfshirjes prej 57,25 ha.'"** do të realizohet me shfaqen e Propozim planit në tabelën për shpallje në Komunën e Jegunovcit.

Anketa publike do të zgjasë **10** ditë pune edhe atë prej **12.04.2019 - 25.04.2019** kurse Prezantimi publik me prezantim profesional të planit do të mbahet me datë **19.04.2019** (e premte) në ora 10:00, në hapësirat e Komunës së Jegunovcit (**salla për mbledhje**).

Në afatin e lartpërmendur, qytetarët e interesuar dhe personat juridik, në listat anketuese të përgatitura nga Komuna e Jegunovcit mund të dorëzojnë vërejtjet e tyre dhe në kohë ti dorëzojnë deri te komuna.

Komuna e Jegunovcit
Kryetar
Darko Bllazheski

Republika e Maqedonisë së Veriut
Universiteti "Shën Kirili dhe Metodij" në Shkup
Fakulteti për mjekësi veterinare - Shkup

L A J M Ë R I M

Në pajtim me vendimin e Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit për mjekësi veterinare në Shkup nr.0202-491/3 të datës 29.03.2019, njoftojmë që

Më datë **16.04.2019** (e marte) me fillim prej orës **11** në hapësirat e Fakultetit të mjekësisë veterinare në Shkup, në mësonjëtoren nr.2, Risto Uzunov, publikisht do ta mbrojë distertacionin e doktoratës me titull:

"Analiza multireziduale e β-agonistëve në matricat biologjike me zbatim të LC-MS/MS metodës.

Dekan,
Prof. d-r Lazo Pendovski

Shesim tokë ndërtimi - 9000m2
Në Komunën kadastrale Zllokuqani, në afërsi të vendit të paparë
për ndërtimin e Qendrës së re klinike, shesim tokë ndërtimi me
sipërfaqe prej 9.000 m2.
Tel. 071/372-215 & 078/243-583

PROVOKON JUVENTUSI, ZBULOHET OFERTA E PARË ZYRTARE PËR IKARDIN

Juventusi ka bërë edhe ofertën e parë zyrtare për Ikardin. Shifra e vënë në tavolinë nga kampionët e Italisë është 50 milionë euro dhe nuk kanë ndërmend që të lëvizin prej saj, edhe pse ajo është shumë larg klauzolës prej 110 milionësh që pretendon ose pretendonte Interi se lojtari mund të vlente, në rast të një shitjeje në të ardhmen

Edhe pse ka aq shumë sulmues apo qoftë edhe mesfushorë ofensivë në grupin aktual të Masimiliano Alegrit, Juventusi nuk ka reshtur kurrë së menduari për Mauro Ikardin, ndonëse një afrim i tij në Torino dhe rendimenti që ai mund të ofronte në radhët e "zebrave" ka përçarë shumë prej specialistëve italianë. Gjithsesi, sipas asaj që tregon në mënyrë ekskluzive e përditshmja "Repubblica", bardhezinjtë jo vetëm që mbeten të interesuar për argjentinasin, por "Zonja e Vjetër" ka bërë edhe ofertën e parë zyrtare për ish-kapitenin e milanezëve. Shifra e vënë në tavolinë nga kampionët e Italisë është 50 milionë euro dhe nuk kanë ndërmend që të lëvizin prej saj, edhe pse ajo është shumë larg klauzolës prej 110 milionësh që pretendon ose pretendonte Interi se lojtari mund të vlente, në rast të një shitjeje në të ardhmen. Në të njëjtën kohë, Juventusi i ka bërë me dije administratorit zikaltër, Xhuzepe Marota, se jo vetëm nuk ka ndërmend që të mendojë një tratativë shkëmbimi kokë më kokë mes "Mauritos" dhe Paulo Dibalës, por ky i fundit nuk është në shitje për asnjë prej skuadrave italiane, ndonëse dyert për klubet e huaja janë të hapura për të sjellë oferta. Duke parë gjithçka ka ndodhur mes Ikardit dhe Interit në këto dy muaj të fundit dhe aq më shumë pas shpërthimit të Spaletit, pas ndeshjes së humbur me Lacion (dje trajneri bëri prapakthehu), të gjitha gjasat janë që numri 9 i Interit do të lërë zikaltrit në fund të sezonit dhe sigurisht që Juventusi, i cili e tentoi edhe vjet, madje e kishte në dorë, siç është konfirmuar edhe nga bashkëshortja-menaxhere, Vanda Nara dy muaj më parë, do t'i ofrojë futbollistit të njëjtën kontratë që kishin përpiluar vjet, e thënë më qartë: 8 milionë euro në sezon neto (pa bonuse) për 5 vitet e ardhshme. Tani i takon Interit dhe Ikardit të zgjidhin gjërat, sepse Juvja nuk ka ndërmend të lëvizë nga propozimet e saj.



Kovacic dëshiron të qëndrojë në Chelsea

Futbollisti i Real Madridit i huazuar në Chelsea po përballet me një të ardhme të pasigurt, përkundër që është i sigurt për preferencat e tij personale. Mateo Kovacic mbetet i pasigurt për të ardhmen e karrierës së tij, mirëpo lojtari vetë dëshiron të qëndrojë në Chelsea, përkundër që Zinedine Zidane është kthyer në pozitën e trajnerit të Real Madridit. Kovacici i ka bërë 41 paraqitje, pa shënuar asnjë gol, që kur u transferua në Stamford Bridge në gusht të vitit të kaluar. Ai iu bashkua Chelsea si huazim për një sezon dhe kontrata e tij me klubin londinez përfundon në fund të këtij viti. Në kontratën e tij nuk ka asnjë klauzolë që do t'ia lehtësonte blerjen Chelseat dhe kjo bën që drejtuesit e klubit anglez do të duhet të negociojnë me drejtuesit e Real Madridit, të cilët nuk duan të shesin futbollistin. Për më tepër, nëse nuk ndryshon asgjë në dënimin që FIFA ia shqiptoi Chelseat, atëherë anglezët nuk do të kenë mundësi të transferojnë asnjë lojtar gjatë dy afateve të ardhshme kalimtare. Më herët, klubeve si Real Madridi, Barcelona e Atletico Madridi u ishte suspenduar përkohësisht dënimi, në pritje të një vendimi përfundimtar. Megjithatë, Chelseat nuk i është ofruar ky opsion. Klubi i Premierligës e ka apeluar vendimin e FIFA-s dhe vendimi për këtë apel do të merret më 11 prill. Nëse dënimi nuk kundërshtoret në tentim të parë, Chelsea do ta apelojë atë te Gjykata e Arbitrazhit Sportiv.

Leicester do të paguajë 40 milionë euro për Tielemans

Leicester City tashmë e ka në skuadër goditjen e madhe për sezonin e ardhshëm. Mesfushori i talentuar, Youri Tielemans, i cili u afrua në huazim në dhjetor nga Monaco, i ka bindur të gjithë, edhe trajnerin e sapoardhur, Brendan Rodgers, ndaj dhe drejtuesit do të bëjnë një sakrifice për 21-vjeçarin. Në përfundim të sezonit aktual, klubi anglez do të derdhë 40 milionë euro në arkën e Monacos për të blerë përfundimisht kartonin e mesfushorit, dëshira e të cilit gjithashtu është të qëndrojë në Premier League.

Gattuso në telashe, Donnarumma një muaj jashtë

Tërheqje në muskujve të kofshës së djathtë: Ky është rezultati i ekzaminimeve mjekësore që iu nënshtrua Gigi Donnarumma pas dëmtimit që pësoi ndaj Udineses. Portieri i Milanit, në këtë mënyrë, do të mungojë në takimin shumë të rëndësishëm me Milanin dhe me shumë mundësi nuk do të jetë në dispozicion të Gattusos edhe në takimin me Lazion. Koha e rikuperimit që nevojitet në raste të tillë është nga 20 deri në 30 ditë, por situata do të vlerësohet ditë pas dite. Shqetëson shumë më tepër situata e Paquetas, që gjithashtu mund të

mungojë për një kohë të gjatë, edhe pse përgjigjen përfundimtare do ta japin kontrollet e mëtejshme mjekësore. Në infermierinë kuqezi gjendet edhe Kessie, që mbetet në dyshim për Juventusin për shkak të një problemi në gju, sikurse Conti. Gattuso do të kërkojë të rikuperojë sa më shpejt Susuon, që mori dy goditje në këmbë gjatë stërvitjes.

Vazhdon beteja mes Cardiffit dhe Nantesit për Salan

Cardiff City dëshiron që të fillojë bisedime të drejtpërdrejta me Nantesin, në tentim për ta zgjidhur mosmarrëveshjen për shumën prej 17 milionë eurove për transferimin e Emiliano Salas, i cili vdiq në një aksident ajror në janar. Organi qeverisës i futbollit botëror, FIFA, u ka dhënë klubeve afat kohor deri më 15 prill për ta zgjidhur këtë problem, pasi Cardiffi nuk e kishte bërë pagesën e parë për transferimin e argjentinasit. FIFA fillimisht kishte kërkuar për më shumë prova, para se ta marrë vendimin përfundimtar për këtë çështje. Megjithatë, Cardiffi pretendon se Nantesi nuk i është përgjigjur thirrjes së tyre për ta aranzhuar një takim. "Cardiff City ka kërkuar dhe e ka fituar zgjatjen e afatit kohor për t'i dhënë përgjigje FIFA për këtë çështje. Së fundi, Cardiff City i ka shkruar Nantesit, duke ia propozuar një takim për t'i diskutuar problemet lidhur me tragjedinë e Emiliano Salas e transferimit të planifikuar", thuhet në deklaratën e lëshuar nga klubi anglez. "Ky propozim është në të njëjtën vijë me kërkesën e FIFA-s që të dy klubet ta gjejnë një zgjidhje sa më shpejt. Deri më tani, Cardiff City nuk ka marrë përgjigje nga Nantesi". Cardiffi pretendon se marrëveshja e arritur me Nantesin për transferimin e Salas nuk ishte ligjërisht obliguese. Ata thonë se kushtet e kontratës, të cilat ishin caktuar nga klubi francez, nuk ishin kompletuar plotësisht. Në anën tjetër, Nantes pretendon se i ka kompletuar të gjitha dokumentet e nevojshme dhe se gjithçka ka qenë në pajtueshmëri me rregullat e FIFA-s. Presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, ka bërë të ditur se ai po shpreson se dy klubet në fjale do ta arrijnë ndonjë marrëveshje mes vete, pa pasur nevojë të ndërhyjë një palë e tretë. Sala, 28-vjeçar, u zyrtarizua si lojtar i ri i Cardiff Cityt më 19 janar. Vetëm dy ditë më vonë, ai vdiq në një aksident ajror, pasi aeroplani me të cilin po udhëtonte nga Nantesi në Cardiff u rrëzua mbi Kanalin Anglez. Aeroplani ishte drejtuar nga piloti David Ibbotson, i cili është ende i zhdukur. BBC-ja ka raportuar se Ibboston nuk kishte qenë i licencuar për ta drejtuar atë aeroplan. Ai besohet se kishte daltonist dhe licenca e tij ishte e kufizuar vetëm gjatë ditës, e jo edhe gjatë natës, kur ishte bërë udhëtimi në fjalë.

REKA PËR REPUBLIKËN
BLERIM REKA PËR PRESIDENT
VOTO
1
blerimreka.org
#EuReka

DASHI 21. mars - 20. prill

Dite mjaft dinamike do jete kjo e sotmja për te dashuruarit. Ata do bëjnë edhe gjera ndryshe vetëm qe emocionet te shumëfishohen. Beqaret do jene idealiste dhe nuk do dalin me çdo njeri qe do i ftoje. Mendimet do i kenë shume te qarta dhe do ecin me plane. Buxhetin do keni vështirësi ta organizoni si duhet dhe situata nuk ka për te qene mjaftueshëm e mire.

DEMI 21. prill - 21. maj

Te dashuruarit do kenë diskutime te gjata me partnerin e tyre dhe do mund te gjenden edhe zgjidhje për disa probleme. Beqaret do kalojnë një dite mjaft romantike dhe te mbushur me emocione te bukura. As qe e kishit menduar ndonjëherë se gjerat mund t'iu ndodhin ne këtë mënyrë. Ne planin financiar yjet do sjellin shume fat megjithatë duhet te shmangni shpenzimet e ekzagjeruara.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Pasi problemeve qe keni pasur kohet e fundit ju te dashuruarit sot do i sqaroni te gjitha dhe do ndiheni me te gatshëm për te hedhur hapa përpara. Beqaret mund te kenë papritur dashuri me shikim te pare te cilat do ua ndryshojnë jetën njëherë e përgjithmonë. Ne pune do lidhni aleance me disa kolege te rëndësishëm dhe shume shpejt keni për te hedhur hapat qe as nuk i kishit menduar ndonjëherë.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Kjo dite do jete shume intensive dhe e mbushur me risi për ju te dashuruarit. Do dashuroheni si asnjëherë me pare me partnerin tuaj dhe nuk do keni me debate si dje. Beqaret do jene me fat dhe do takojnë persona mjaft interesante. Me shpenzimet mundohuni te jeni sa me te arsyeshëm ne mënyrë qe as nesër te mos keni probleme dhe vështirësi. Duhet te mendoni edhe për te ardhmen.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Nëse jeni ne një lidhje duhet te tregoheni sa me te matur dhe besnike. Po e kaluat pa probleme edhe këtë dite me pas çdo gjë do ju ece me mire. Kujdes vetëm me xhelozinë. Beqaret mund te kenë plot mundësi për njohje, por nuk do arrijnë dot te përqendrohen vetëm tek një person. Me mire le te qartësojnë njëherë mendimet e me pas te veprojnë. Ne planin financiar mos ndërmerrni rreziqe.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Te gjitha përpjekjet qe keni bere kohet e fundit për ta përmirësuar jetën tuaj ne çift, sot do japin rezultatet e veta. Do ju rikthehet buzëqeshja. Beqaret do afrohen me disa kolege te vjetër dhe për here te pare do i shohin ata me një sy tjetër. Ne planin financiar nuk do jeni me shume fat kështu qe kujdes me shpenzimet qe do kryeni. Duhet menduar edhe për te ardhmen.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Sot do ndiheni te lire te bëni atë qe do ndieni ju te dashuruarit. Marrëdhënia ne çift ka për te qene e jashtëzakonshme dhe mund te jeni gati edhe te merrni vendime te mëdha. Beqaret edhe sikur te duan nuk do i shpëtojnë dot një dashurie me shikim te pare. Ne planin financiar duhet ta dyfishoni vigjilencën ne mënyrë qe te mos keni aspak probleme. Hua mos jepni ne asnjë

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Dite e mrekullueshme do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Shume gjera do jete me ndryshe nga me pare dhe do ndiheni te plotësuar tërësisht. Beqaret duhet te falënderojnë yjet qe do ju krijojnë mundësi te gjene princin e kaltër. Shpenzimet duhet t'i bëni me llogari sepse ne te kundërt mund t'iu dalin probleme. Investimet e mëdha lërini për disa dite me vone.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Do jeni shume tolerante me njeri-tjetrin gjate kësaj dite dhe marrëdhënia ne çift do filloje te përmirësohet ndjeshëm. Beqaret me ne fund do gjejnë personin qe do ju përshtatet ne çdo pike. Nuk duhet te humbasin shume kohe duke u njohur me ta, por duhet te mendojnë sa me shpejt te hedhin hapa. Ne planin financiar çdo gjë do ece mire nëse tregoheni te matur.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Perspektivat për ata qe janë ne një lidhje duket te jene shume te mira gjate kësaj dite. Do kaloni me tepër kohe me partnerin dhe nuk do mungojnë as çastet pasionante here pas here. Beqaret do kërkojnë me çdo kush ta ndryshojnë statusin dhe ky nxitim mund t'i shtyje drejt gabimeve. Buxhetin do dini si ta menaxhoni ne çdo moment kështu qe gjendja do mbetet e qëndrueshme.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Yjet do ju bëjnë me te logjikshëm dhe me te duruar sot ju te dashuruarve. Do dini si ta ruani harmoninë dhe alegrine ne çift, prandaj partneri do ndihet me fat qe ju ka. Beqaret do kenë disa takime te veçanta, por do presin edhe pak kohe para se te hedhin hapa. Buxheti do varet tërësisht prej sjelljes tuaj. Po bëtë gabime keni për te vuajtur për kohe me radhe.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Jupiteri do ju sjelle fat dhe mbështetje te madhe ne jetën tuaj ne çift gjate kësaj dite. Do ndiheni mjaft mire ne çdo moment dhe kënaqësitë do jene te paimagjinueshme. Shume do ju kenë zili, kështu qe duhet te bëni kujdes mos ua prishin harmoninë. Beqaret do kenë disa takime, por asnjeri nuk do ju duket interesant. Ne planin financiar gjerat nuk do jene shume mire.



Mensur Mamuti	KËNGËTARI IRLANDEZ NË FOTO		HIT I KËNGËTARIT NË FOTO		AKTORJA ITALIANE, LOTI / AKTOR I YNI (ISMAIL)		K		NINULLAT	
GJUHË QË FLITET NË INDI (KAMAN)										
MODELJA JAPONEZE, ASAHINA / SPRINTERI GRENADIAN, TAPLIN										
B										
QYTET NË ITALI										
AKTORJA AMERIKANE, FOKS										
RRUGA / QYTET NË ANGLI								AMPER / BIMË E NGJASHME ME GRURIN (BIRRA)		
KOHA	KËNGËTARË TE ROKUT / TITULL KATOLIK	R	QYTET NË ITALI	QYTET NË GJERMANI / FLORI						
DOSJE						LLOJ PESHKU I UJËRAVE TË ËMBLA / EMRI I VJETËR I NISH				
INSTRUMENT FRYMOR								BEDRI TAHIRI / RANISHTET		
AKTORI AMERIKAN, GIBSON				KËNGËTARI FEJZULLAHU / POST SCRIPTUM						MI (ANG.)
KOHA	ZVARRANIKË / KËNGËTARJA ITALIANE, ZADORA								METËR / SHKOVA	
TË QENËT I PËRSOSUR										
IMPULS		NORVEGJI / GJERMANI		LODËRTARI, LOZONJARI / AZOT						
EMRI I TËI BIRIT TË KINIRIT, MBRETIT TË QIPROS SIPAS MITOLOGJISË GREKE							ENË E THELLË USHQIMI			

ZGJIDHJET: K, GEMAN, AKARI, BRALON, IMOLA, MEGAN, UDHA, A, R, BREMEN, DOSAR, NJILA, OKARINË, BT, MEL, SABRI, REPTILË, M, PËRSOSURIA, I, N, LOZAKU, ADONIS, TAS.

Sudoku

shumë i lehtë

	3		9		4			5
	9						1	4
5		1		3				
4								2
		5		6		1		
9								3
				9		8		6
	8						7	
7	5		3		6		4	

mesatar

		9	6		3	5		
			4		9			
	6			2			3	
3	2			4			1	5
		5	3		1	8		
8	9			5			6	4
	1			3			7	
			7		4			
		7	8		6	1		

Shumë i lehtë: 837914625, 692578314, 541632987, 413859762, 275463198, 968127453, 124795836, 386241579, 759386241. **Mesatar:** 149683527, 532479681, 768125439, 326948715, 475361892, 891257364, 614532978, 983714256, 257896143.

DËGJIMI I KËTIJ ZHANRI TË MUZIKËS IU MBRON NGA PICKIMI I MUSHKONJAVE

Prodhimet muzikore të 'playlist'-ës 'Dubstep' nga DJ-i Skrillex mund të ofrojë mbrojtje efektive kundër pickimit të mushkonjave, sipas një studimi të ri. Një ekip ndërkombëtar i shkencëtarëve vlerësoi efektet e muzikës elektronike (electro) në 'Aedes aegypti'– të njohur si mushkonja e verdhë. Kjo specie është e njohur për përhapjen e sëmundjeve të rrezikshme dhe, nganjëherë edhe kërcënuese për jetën, duke përfshirë këtu edhe virusin Zika dhe ethet e dengutit. Ekipi zgjodhi muzikën "Scary Monsters And Nice Sprites" për përzierjen me muzikë të tjera të frekuencave shumë të larta dhe shumë të ulëta. Sipas rezultateve, të botuara në revistën 'Acta Tropica' më 25 mars, mushkonjat e rritura u "argëtuan" me muzikën në vazhdimësi. Femrat e ekspozuara ndaj muzikave elektro gjithashtu sulmuan pengjet, që ishin pjesë e eksperimentet, më pak se ato në një mjedis pa muzikë elektro. Kjo ndodhte si rezultat i uljes së dëshirës për pirje gjaku përgjatë dëgjimit të tingujve me frekuenca të larta.

Skrillex, emri i vërtetë i të cilit është Sonny John Moore, nuk dha ndonjë deklaratë zyrtare. Megjithatë, ai bëri "retweet" një artikull në lidhje me studimit në rrjetin social 'Twitter'.

Pishina më e thellë në botë do të hapet në Poloni

Për të apasionuarit pas zhytjes ka një risi. Në Poloni është drejt përfundimit pishina më e thellë e botës, që mbërrin deri në 45 metra. Pishina premton të jetë vendi ideal për zhytësit profesionistë, por edhe amatorët. Ajo do të mbajë 8.000 metra kub ujë, një vëllim 27 herë më i madh sesa ai i një pishine të zakonshme 25 metërshe. Pishina "DeepSpot" po ndërtohet në qytetin Msxczonow, të ndodhur shumë pranë Varshavës. Rreth 1.100 ton çelik po përdoren për të forcuar strukturën e saj, e cila përmban edhe një të ashtuquajtur "vrimë blu", vendi që shënon edhe thellësinë më të madhe. Ideatorët thonë se kjo pishinë do të jetë ideale si për fillestarët, ashtu dhe për zhytësit me eksperiencë. Ndërsa për ata që nuk duan të lagen nga uji, ka edhe një tunel nënujor, i cili iu ofron spektatorëve një pamje të rrallë. Kur të jetë gati për publikun, "DeepSpot" do të thyejë rekordin e pishinës italiane "Y-40 The Deep Joy" të ndodhur në Montegrotto Terme, e cila është 42.15 metra e thellë.

Kanada po ngrohet dy herë më shpejt se vendet tjera të botës

Kanadaja po ngroh mesatarisht me një ritëm dy herë më të shpejtë se pjesa tjetër e botës, tregon një raport i ri shkencor. Raporti i klimës i qeverisë federale gjithashtu paralajmëron se ndryshimet janë tashmë të dukshme në shumë pjesë të vendit dhe pritet të intensifikohen. Arktiku i Kanadasë ka parë ndikimin më të thellë dhe do të vazhdojë të ngrohë në më shumë se dyfishin e normës globale. Raporti sugjeron se këto efekte janë tashmë të pashmangme. Temperatura mesatare vjetore e Kanadasë është rritur me rreth 1.7C (3F) që nga viti 1948, kur u regjistruan për herë të parë temperaturat në mbarë vendin. "Ndërsa aktivitetet njerëzore dhe variacionet natyrore në klimë kanë kontribuar në ngrohjen e vëzhguar në Kanada, faktori njerëzor është dominues", thuhet në raport. Efektet e ngrohjes globale në mjedisin e Kanadasë përfshijnë motin më ekstrem. Temperaturat e nxehta mund të nënkuptojnë më shumë valë të nxehtësisë dhe një rrezik më të madh të zjarreve dhe thatësirës në disa pjesë të vendit. Oqeanet priten të bëhen më acid dhe më pak të oksigjenuar, gjë që mund të dëmtojë jetën detare. Një rritje në nivelet e detit mund të rrisë rrezikun e përmbytjeve bregdetare dhe reshjet më intensive mund të shkaktojnë probleme me përmbytjet në qendrat urbane.

Policët detyrohen të bien në gjunjë para bandës kriminale në Meksikë

Të paktën tre policë janë detyruar të bien në gjunjë pasi një bandë kriminale kishte kidnapuar 11 zyrtarë policorë në Meksikë. Agjentët e Policisë së shtetit ishin duke patrulluar në qytetin Juan Galindo kur u përballën me të shtëna armësh në mbrëmjen e së shtunës.

Sipas raportimeve, policët sapo kishin përfunduar një operacion që kishte parandaluar vjedhjen e një rafinerie nafte. "DailyMail" ka publikuar fotografi të kësaj skene ku shihen tre nga 11 policët që kishin rënë në gjunjë para anëtarëve të bandës, që sipas raportimeve ishin më në numër se policët. Policët më pas ishin dërguar në një zonë tjetër dhe u gjetën të dielën në mëngjes. S'ka pasur të arrestuar lidhur me rastin.

Qeveria meksikane është përfshirë së fundmi në një përballje të vazhdueshme me organizatat kriminale. Që nga viti 2016, kompania e naftës "Petroleos Mexicanos" ka pësuar rënie të vlerës për shkak të vjedhjes së 7.4 milionë dollarëve. Vjedhja e karburantit ka nisur një luftë mes karteleve duke rritur numrin e grabitjeve dhe vrasjen e njerëzve të pafajshëm.

KALENDARI HISTORIK 4 PRILL

1081 - Aleksi i I Komneni okupon fronin bizantin.

1460 - Formohet Universiteti i Bazelit në Zvicër.

1716 - Trupat ruse dhe prusiane okupojnë Uajsmarin.

1818 - Kongresi amerikan vendos që flamuri i SHBA të ketë 13 vija kuq e bardhë dhe 20 yje.

1866 - Aleksandri i II i Rusisë në mënyrë të ngushtë i ik një tentimi për vrasje në qytetin e Kievit.

1912 - Republikë kineze shpallet në Tibet.

1926 - Diktatori grek Teodoros Pangallos zgjidhet president.

1944 - Trupat britanike okupojnë Adis Abeban në Etiopi.

1945 - Hungaria lirohet nga okupimi nazist (Dita kombëtare).

1960 - Senegali shpall pavarësinë nga Spanja.

1979 - Ekzekutohet kryetari i Pakistanit Zulfikar Ali Bhutto.

1992 - Sali Berisha bëhet kryetar/Aleksandër Meksi kryeministër i Shqipërisë

A E DINI SE...

Biznesi i Pablo Escobarit shënonte një humbje mujore prej 2.1 miliard dollarësh, por kjo nuk ishte asgjë krahasuar me fitimin.



Ajsbergu më i madh i matur deri më sot ka qenë me gjatësi 200 milje dhe me gjerësi 60 milje, dhe ai ka patur një sipërfaqe më të madhe se Belgjika.



Ulërima e luanit është shumë e zëshme dhe e fuqishme sa që mund të dëgjohet deri në 8 kilometra larg.

BARSOLETA

Puntorët
Dy vetë bartin piano në katin e shtatë të një pallati.
Pasi arrijnë, të mbushur frymë, njëri thotë:
– Të them të drejtën, më shumë e dua flautin!
– Pse?
– Ka zë më të këndshëm!

THËNIA E DITËS

Detyra e një patrioti të vërtetë është ta mbrojë vendin e tij nga qeveria e tij.
(Thomas Paine)